

REPUBLIKA E MAQEDONISË, ZGJEDHJE LOKALE 2013

LUFTIË E
PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHITET

ANALIZA, RAPORTE DHE REKOMANDIME

REPUBLIKA E MAQEDONISË, ZGJEDHJE LOKALE 2013

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

ANALIZA, RAPORTE DHE REKOMANDIME

autorë:

raporte dhe analiza

Xhabir Deralla, Haralld Shenker, Albulena Karaga

raporte për mediat

Risto Popovski, ilir Ajdini, Anushka Cvetkovska

Civil - Qendër për liri

www.civil.org.mk

Shkup, 2013

impresum

botues

Civil - Qendër për liri

autorë

raporte dhe analiza

Xhabir Deralla
Haralld Shenker
Albulena Karaga

raporte për mediat

Risto Popovski
Iilir Ajdini
Anushka Cvetkovska

asistentë

Kate Hristovska
Sonja Eftovska
Marija Josifovska
Kristina Mitkovska
Semra Amet
Frosina Mitrusheva
Arian Mehmeti
Stefan Urxhanovski
Mario Jankullovski

Shtyp: ТП „Дуле 99“
Tirazhi: 200 kopje

Çdo kopje të librit e shoqëron edhe nga një CD
me titullin e projektit

Adresa e botuesit: Civil, Mito Haxhivasilev
Jasmin 12/5, 1000 Shkup, R. Maqedonisë

Ky publikim është pjesë e
**PROJEKTIT ZGJEDHJE
TË LIRA DHE PA DHUNË 2013**
Me përkrahje financiare nga Agjencia
Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
**Përmbajtja e këtij materiali i paraqet
pikëpamjet e autorëve dhe jo domosdo i
reflekton qëndrimet e SDC-së**

ISBN-13 978-9989-2001-6-8

përmbajtja

Parathënie 5

Sfondi politik 11

Raport 23

Ditët e votimit 45

Periudha pas zgjedhjeve 59

Mediat në zgjedhjet 63

Rekomandime 93

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

PARATHËNIE

Projektin Zgjedhje të lira dhe pa dhunë 2013 e zbatoi Civil – Qendra për Liri me mbështetje financiare nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Projekti u zbatua në nivel kombëtar dhe përbante dy komponente kryesore:

A. Ngritja e vetëdijes publike për kulturën zgjedhore dhe parandalimin nga dhuna dhe dhuna e armatosur;

B. Puna në terren – puna në terren ishte shumë intensive dhe ishte e përqendruar në parandalimin e parregullsive zgjedhore, dhunës dhe dhunës së armatosur gjatë gjithë procesit zgjedhor si dhe para zgjedhjeve.

Civil prodhoi 8 video klipe për TV fushatë dhe 20 radio xhingla me mesazhe për mbështetjen e zgjedhjeve të lira dhe pa dhunë. Ekipi i Civilit disenjoi një numër të madh materialesh grafike për shtyp dhe publikime onlajn. Mesazhet e fushatës u transmetuan përmes 6 stacioneve televizive, 9 radio stacioneve dhe 8 portaleve në internet. Të gjitha prodhimet e fushatës ishin në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Ekipi kreativ i Civilit prodhoi edhe filma dokumentarë; në vend të dokumentarit të paraparë prej 30 minutave janë prodhuar katër filma dokumentarë. Kësaj Civili ia bashkëngjiti edhe 16 video klipe në kuadër të fushatës joformale të quajtur “Le të bëhemi seriozë” me qëllim që ta përforcojë vetëdijen publike përmes sloganeve humoristike.

Fushata përfshiu aktivizimin intensiv onlajn. Ueb faqja e Civilit dhe profilet e rrjeteve dhe platformave sociale (Facebook, Twitter, YouTube,

Pinterest, Soundcloud etj.) janë plotësuar me përmbajtje çdo orë ditë e natë.

Civil hyri në bashkëpunim dhe partneritet me disa organizata, si Forumin Servisi Civil Paqësor (Forumi ZFD), Institutin për Zhvillimin e Bashkësisë – Tetovë, Qendrën për Zhvillimin e Bashkësisë së Kërçovës, Fondacionin për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale – Shtip dhe Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoni.

Projekti u mbështet nga një sërë organizatash të tjera si Asociacioni i Gruas Shqiptare nga Kërçova, Qendra Kulturore në Manastir etj. Koordinimi dhe bashkëpunimi u vendos edhe me Asociacionin Qytetar MOST dhe Institutin Kombëtar Demokratik (IKD). Kontakte të rregullta janë mbajtur me misionin e OSBE/ODIHR, si dhe me një sërë organizatash dhe kontaktesh të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Ky projekt është shembull për bashkëpunimin e afërt dhe partneritetin midis qytetarëve/qytetareve dhe sektorit për shoqëri civile, Civil njihet nga qytetarët/qytetaret e Republikës së Maqedonisë si organizatë neutrale, konsekuente dhe e ndershme. E shfrytëzojmë këtë mundësi t'i falënderojmë qytetarët/qytetaret për mbështetjen e tyre dhe thirrjet dhe mesazhet e shumta me informacione për situatën në bashkësitë e tyre.

Civil formoi Grupe të punës për parandalim në nëntë qendra rajonale (Shkup, Kumanovë, Tetovë, Kërçovë, Ohër, Manastir, Strumicë, Shtip dhe Veles). Numri i njerëzve të angazhuar në projekt arriti 160 persona, prej të cilëve 128 të akredituar në Komisionin Shtetëror Zgjedhor. Këto numra i përfshijnë edhe anëtarët e organizatave partnere.

Vëzhgimi i procesit zgjedhor filloi më 17 dhjetor dhe zgjati deri në fund të prillit. Disa aspekte të vëzhgimit tonë përfshijnë edhe periudha para dhe pas datave të shënuara.

Civil e vëzhgoi situatën e përgjithshme politike, praktikat e partive politike dhe institucioneve qeveritare, marrëdhëniet ndëretnike dhe mediat. Metodologjitë e monitorimit përfshijnë kontakte të afërta dhe grumbullim të informatave në terren, të ndara në disa kategori, si intervista individuale, pyetësorë, fokus-grupe etj. Secili anëtar i personelit përgatiste të paktën nga fy raporte në javë të cilat ia dërgonte ekipit analitik të Civilit. Ekipet mobile ishin gjithmonë në dispozicion që të ofrojnë përkrahje të ndryshme për ekipet në terren, të distribuojnë materiale për ngritjen e vetëdijes publike dhe të organizojnë aktivitete dhe evente mediale. Ngjarjet lokale përfshinin takime në bashkësinë, tryeza të rrumbullakëta, pres konferenca dhe intervista për mediat lokale, takime me partitë politike dhe aktivistët e tyre, me OJQ-të, pushtetin lokal dhe policinë, stenda informative etj.

Mbi 400 deklarata dhe intervista u dhanë në mediat lokale dhe kombëtare, si dhe në disa media ndërkombëtare. Mbi një mijë artikuj medialë u publikuan në gjashtë muajt e implementimit të projektit. Dhjetëra mijëra materiale të shtypura arritën deri në vendbanimet më të largëta të vendit, ndërsa me qindra njerëz u kontaktuan për çdo ditë. Dukshmëria e projektit ishte më se masovike.

Rezultoi se projekti ndihmoi për qetësimin e tensioneve dhe incidenteve ndëretnike që u paraqitën gjatë procesit zgjedhor, por veçori edhe si vegël që kontribuoi për dialog politik në kushte të krizës serioze politike në vend. Civil e organizoi edhe konferencën “Perspektivat demokratike” kushtuar kulturës politike dhe dialogut, ku politikanë, OJQ dhe media u takuan dhe biseduan për perspektivat e vendit dhe propozuan zgjidhje për tejkalimin e sfidave në kontekst të zgjedhjeve.

Civil dhe personeli i organizatave partnere shfaqën entuziazëm të madh dhe përkushtim për plotësimin e objektivave të projektit. Ekipi projektues i zyrës koordinative të Civilit përbëhet nga njerëz me integritet dhe kurajo të rrallë, me shkathtësi profesionale dhe etikë të lartë.

Në këtë libër do të gjeni analiza dhe raporte për procesin zgjedhor, për situatën politike, por edhe për gjendjen e medias, si dhe rekomandime për aktorët kryesorë shoqërorë, politikë dhe institucionalë të vendit. Me rëndësi është të ceket se kjo paraqet vetëm një përzgjedhje nga mijëra faqet e raporteve që arritën gjatë projektit. CD-ja që e shoqëron publikim përmban zgjedhje të shkrimeve, analizave dhe raporteve që veçmë janë publikuar në www.civil.org.mk. Shpresojmë se ky publikim do të ndihmojë për zhvillimin e kulturës politike dhe për zgjedhje të lira dhe pa dhunë edhe në të ardhmen.

LUFTË
E PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHTET

ПРАВНО-ПОЛИТИЧКИ КОНТЕКСТ

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

Sfondi politik

Në vitin 2012 Maqedonia kaloi në një periudhë të shënuar me nivele të larta të tensioneve politike e cila rezultoi me shpërthim të dhunës strukturore, politike dhe fizike në fund të vitit.

Tensionet vëreheshin në më shumë nivele, ndërsa ishin jo vetëm të brendshme etnike, por edhe ndëretnike. Koalicionin qeveritar e kanë tronditur incidentet dhe tensionet ndëretnike disa herë. Vrasja e dy të rinjve në Gostivar nga ana e një polici jashtë punës, shkaktoi një sërë incidentesh të dhunshme midis të rinjve. Duke pasur parasysh se ngjarjet e këtilla rrallë herë ndodhin vetvetiu spontanisht, ishte e qartë se aktorët politikë, kryesisht të dy partnerët e koalicionit - VMRO-DPMNE dhe BDI, e kanë filluar procesin me mobilizimin e grupeve të rrugës në rast të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, duke treguar se krijimi i politikës etnike mbetet prioritet mbi interesat e të gjithë qytetarëve.

Incidenti brutal në të cilin u vranë katër të rinj dhe një person i rritur në afërsi të Shkupit shkaktoi një prej veprimeve të tepruara tipike policore, në të cilin policia speciale bënte aksione dhe arrestonte njerëz aty-këtu, duke shpikur akuza qesharake për terrorizmin islamik, qoftë nga paaftësia, qoftë nga mungesa e dëshirës për ta hetuar prapavijën kryesore të vrasjeve. Shumë pak nga arrestimet masovike u vërtetuan. Persona të pafajshëm u akuzuan në mënyrë të rremë si dhe u torturuan, ndërsa teoritë e konspiracionit lulëzuan. Rasti përsëri i hapi plagët e pashëruara kolektive dhe në mënyrë plotësuese kontribuoi për thellimin e hendekut midis dy bashkësive etnike në Maqedoni, si dhe për humbjen e vazhdueshme të besimit të qytetarët për kapacitetin e institucioneve shtetërore, veçanërisht të policisë për plotësimin e detyrave të saj.

Edhe njëra prej ngjarjeve që politikisht e tronditi opinionin në Maqedoni ishte vizita dhe nderimet përmendores së ushtarëve të rënë të UÇK-së në fshatin Sllupçan nga ana e ministrit të atëhershëm të Mbrojtjes, Fatmir Besimi. Ky gjest u interpretua si provokim i qëllimshëm për "normalizimin" e statusit të ish-luftëtarëve të UÇK-së në debatin për statusin social të luftëtarëve në konfliktin e vitit 2001 dhe shkaktoi reagime të dhunshme. U mobilizuan të gjitha grupet rrugore për të shkaktuar incidente, duke e theksuar ekzistimin e fuqisë së gatshme huligane.

VMRO-DPMNE e filloi procedurën për "Ligjin për ish-pjesëtarët e forcave të sigurisë" me të cilin rregullohen të drejtat e veçanta për anëtarët e forcave të sigurisë të cilët morën pjesë në konfliktin etnik të vitit 2001. Partneri në koalicionin qeveritar, BDI, u përgjigj me 15.000

amendamente me qëllim që ta parandalojë procedurën, duke theksuar se ligji duhet të sigurojë trajtim të barabartë për luftëtarët e UÇK-së. Në vjeshtën e vitit 2012, një sërë veprimesh me qëllim të keq filluan ta gërryjnë kredibilitetin edhe ashtu të keq të Parlamentit në opinion, me ç'rast mediat filluan t'i përqeshin, ndërsa opinioni publik prej tyre të bëjë shaka. Pas diskutimit maratonik për ligjin për "brantellat", gjegjësisht statusin e luftëtarëve në vitin 2001, një prej deputetëve vendosi ta bllokojë punën në komisionin kuvendor përkatës duke refuzuar ta braktisë foltoren, me ç'rast në intervale reciproke pasoi heshtje, lexim i poezive, ose mbajtje e leksioneve për tema të ndryshme mbi dhjetë ditë me radhë. Gjatë diskutimit preliminar të debatit kuvendor të komisionit për buxhetin shtetëror për vitin 2013 në dhjetor, puna e komisionit vijoi me kanosje të ashpra verbale, ndonjëherë edhe fizike midis deputetëve. Kur Qeveria tentoi të sjell buxhetin në një sesion plenar, duke e injoruar në mënyrë arrogante faktin se puna e komisionit përkatës është larg përfundimit, ngjarjet eskaluan me atë që LSDM-ja opozitare u përpoq ta parandalojë mbajtjen e seancës. Në fund edhe deputetët, por edhe gazetarët të cilët e ndoqën seancën e Kuvendit u përjashtuan me forcë nga policia speciale dhe sigurimi i Kuvendit. Në të njëjtën kohë, para ndërtesës së Kuvendit mezi u arrit të pengohen përleshjet masovike të mbështetësve të dy blloqeve politike. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, LSDM-ja filloi me bojkotimin e punës së Kuvendit, bojkotim i cili përfundoi më 1 mars të vitit 2013 me kompromisin i cili u arrit me ndërmjetësimin e BE-së.

Skenat e brutalitetit të paparë deri më atëherë në Kuvend dhe tensionet në rrugët e Shkupit në masë të madhe janë transmetuar në media dhe paraqesnin fundin adekuat të një viti të mbushur me tensione, me theks në trendin e eskalimit të garës politike në nivel të luftës së hapur midis liderëve, lidhshimit dhe mbështetësve të tyre, deri te statistët e paguar.

Opozita vendosi protestën e saj ta shprehë jashtë institucioneve, duke organizuar një sërë tentimesh përafërsisht të pasuksesshme për atë që vetë e quajtën "mosbindje civile", gjegjësisht bllokimin e rrugëve kryesore nga 30 minuta, në lokacione të ndryshme çdo ditë. Protestat u shoqëruan me kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Nuk ishte befasi që sukcesi i aktiviteteve rreth festave të fundvitit ishte mjaft i thjeshtë në shoqërinë e Maqedonisë. Megjithatë, i njëjti shkaktoi interesim ndërkombëtar, pasi që kriza politike u reflektua negativisht në angazhimet politike që i bëri qeveria si pjesë e Dialogut inkuadruar të nivelit të lartë (DINL) dhe u kanos ta nxjerr nga binarët të procesit.

Involvimi i nëpunësve të lartë të BE-së, përfshirë edhe Komisararin për

zgjerim Shtefan Fyle në çmendurinë e diplomacisë ndërmjetësuese në fund solli kompromis. Përmbajtja e kompromisit u bë mjaft e paqartë në mënyrë që të dy palët të mund të pajtohen me të. Përfshinte kthimin e opozitës në kuvend, pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet lokale, formimin e komisionit për hetimin e ngjarjeve të 24 dhjetorit 2012 dhe mbajtjen eventuale të bisedave për zgjedhje të parakohshme parlamentare, si dhe obligimin që qeveria t'i zbatojë rekomandimet e tjera të OSBE-së dhe Komisionit të Venecias në raport me legjislaturën zgjedhore. Edhe krahas kësaj, një nga kërkesat kryesore të LSDM-së të theksuara gjatë protestave, që përgjegjësit për ngjarjet e dhjetorit 2012 të japin dorëheqje, nuk u plotësua.

Rezultati i dëshiruar u arrit, LSDM-ja u kthye në Kuvend dhe mori pjesë në zgjedhje. Megjithatë, e paplotësuar deri më sot mbetet pjesa qendrore e marrëveshjes, gjegjësisht vendosja e komisionit për hetim, me çka çështja e përgjegjësisë për ngjarjet e dhjetorit mbetet pezull në ajër. Akoma nuk janë mbajtur bisedimet për zgjedhje parlamentare të parakohshme.

Është interesante në veçanti për t'u theksuar ajo që partitë shqiptare – edhe ajo në qeveri edhe tjetra në opozitë- abstenuan në këtë parodi demokratike, duke e vlerësuar si problem maqedonas. Ngadalë depërtoi informacioni se jashtë syve të opinionit, megjithatë janë mbajtur biseda, nuk është dhënë kurrfarë raporti për opinionin. Fakti që koalicioni qendroi gjatë krizës tregon se ekziston pëlqim i heshtur nga ana e BDI-së për mënyrën në të cilën partneri i tyre i koalicionit ka vendosur të veprojë.

ASPEKTET JURIDIKE

Ndryshimet e kodit zgjedhor u miratuan më 2 mars, ndërsa me to afati i paraqitjes së kandidaturave për kryetarë komunash dhe listave të këshilltarëve u zgjat deri më 8 mars. Megjithatë, i njëjti nuk është pasqyruar në pjesët e tjera të rregullativave ligjdhënëse, me çka u shkaktua konfuzion dhe sjellje kontroverze.

Qeveria nuk zbatoi një pjesë të konsiderueshme të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venecias të vitit 2011, të cilat janë dedikuar për përmirësimin e legjislaturës zgjedhore.

Edhe krahas asaj që kryetarët e komunave zgjidhen drejtpërdrejt, këshilltarët zgjidhen përmes sistemit proporcional me lista të mbyllura partiake, me çka votuesit privohen nga shprehja e zgjedhjes së tyre personale dhe detyrohen të votojnë për pakon në të cilën nuk e dinë se

çka ka. Ky sistem ngjashëm me sistemin me të cilin organizohen zgjedhjet parlamentare promovon jetëgjatësi të nepotizmit dhe klientelizmit midis politikanëve të gjithëfuqishëm dhe qytetarëve të privuar.

CIVIL mori shumë njoftime nga qytetarët të cilëve nuk u është lejuar të votojnë pasi që nuk kanë qenë në listat zgjedhore. Disa të tjerë janë ankuar se është dashur “të shëtisin” nga njëri vendvotim në tjetrin midis dy raundeve, veçanërisht në komunën Qendër të Shkupit. Ligjshmëria e hapave të këtyre kërkimeve, pasi që ka pasur indicje se një gjë e tillë është bërë me qëllim për votuesit të cilët dihet se e mbështesin opozitën.

Vazhdon transparenca e pamjaftueshme rreth financimit të fushatave të partive politike. Edhe krahas asaj që pas përfundimit të zgjedhjeve, partitë dhe kandidatët obligohen t’i tregojnë rezultatet financiare, të njëjtat rrallë herë e pasqyrojnë realitetin. Në këto zgjedhje lokale, vetëm partia në pushtet VMRO-DPMNE shpenzoi shumë për fushatë e cila është më e lartë se ajo që e shpenzuan të gjitha partitë e tjera bashkë, nëse jo tjetër, hapi një sërë dyshimesh për atë se nga vijnë ato para. Vazhdimisht janë shprehur konstatimet për fondet e zeza me të cilat financohen „operacionet për t’i bindur votuesit”.

Është simptomatike ajo se asnjë parti politike nuk u angazhua fuqimisht për zbulimin e këtyre parregullsive serioze, që flet për atë se në interes të përgjithshëm për të gjithë aktorët në procesin politik është të ketë qasje kjo mundësi e financimeve “të turbullta”.

ANALIZA E KONSTATIMEVE

Zgjedhjet lokale 2013 ishin edhe një konfirmim i faktit se politika e Maqedonisë në disa vitet e kaluara është sjellë në nivelin e përballjeve të personalizuar të liderëve të dy partive etnike maqedonase: VMRO-DPMNE dhe LSDM. Mënyra në të cilën ata dhe makineritë e tyre sillen me njëri-tjetrin të përkujton periudhën klasike të udhëheqjes ballkanike me politikën – fundin e shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX, kohë kur oponentët politikë janë konsideruar kundërshtarë personalë, ndërsa makineria e tyre partiake pronë personale, ose vetëm instrument për plotësimin e ambicieve personale të liderit. Ky qëndrim e përshkruan edhe rivalitetin politik të Nikolla Gruevskit dhe Branko Cërvenkovskit dhe shumë kontribuon për degradimin e vetë partive politike, si dhe të institucioneve shtetërore. Ngjarjet e 24 dhjetorit 2012 ishin kulminacion në këtë drejtim, si dhe shenjë se është arritur kufiri i tolerancës së

bashkësisë evropiane.

Ngjarjet paraqesin precedent i cili mund të jetë shumë i rrezikshëm nëse komisioni ad-hok nuk ka mundësi reale për ta mbaruar punën e tij ose nëse nuk e kryen detyrën siç duhet, ndërsa ajo është ta ndriçojë sfondin e këtyre ngjarjeve dhe t’i emërojë fajtorët. Rreziku i mundshëm është në faktin që edhe nëse institucioni më i lartë shtetëror nuk mund të konsiderohet si i sigurt nga dhuna, atëherë nuk do të ekzistojë mënyrë tjetër institucionale për parandalimin e brejtjes së parimeve dhe procedurave demokratike, me çka drejtpërdrejt hapet rruga për rrënimin e tyre. Interesi ynë në mungesë të dhunës në arenën politike kërkon që CIVIL të vazhdojë t’i ndjekë ngjarjet lidhur me keqpërdorimin e institucioneve shtetërore për qëllime personale dhe politike dhe në mënyrë serioze të angazhohet me këtë problem.

FAKTORËT AFATGJATË TË CILËT E PREKËN PROCESIN ZGJEDHOR

Një pjesë e mirë e parregullsive dhe korrupsioni i proceseve politike në Republikën e Maqedonisë paraqesin rezultat të mangësive të shumta sistematike dhe shoqërore, të cilat ndikojnë negativisht mbi proceset zgjedhore në vend në afat të gjatë.

Zgjedhjet vetvetiu nuk kanë shkaktuar konflikt, por gara e paskrupullt për pushtet dhe shfrytëzimi i tepërt i pushtetit janë ato të cilat i ushqejnë ndarjet e ekzistuese shoqërore, politike dhe etnike në vend të cilat janë rrënjësor thellë dhe sjell polarizim më të madh dhe përkeqësim të demokracisë.

Partizimi ose politizimi i institucioneve është shumë i gjerë dhe shumë i pranishëm dhe tërësisht e minon nivelin e demokracisë dhe sundimin e së drejtës. Institucionet janë instrument kryesor për qeverisjen gjithnjë më të thellë dhe të dukshme të një grupi të vogël njerëzish të cilët e mbajnë pushtetin në duart e tyre, ndërsa të cilët partinë politike në pushtet e shfrytëzojnë si rezervuar. Mosfunksionimi i institucioneve çon drejt çrregullimit serioz të procesit zgjedhor, një kohë të gjatë para caktimit të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, parregullsitë zgjedhore dhe mashtrimet janë bërë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave të cilat i minojnë zgjedhjet shumë kohë para se ato të fillojnë.

Edhe krahas rekomandimeve ndërkombëtare për reforma dhe an-

gazhimin deklarativ të politikanëve vendorë, gjyqësia mbetet gjithnjë e më shumë e politizuar dhe e lënë në vullnetin e liderëve partiakë të cilët janë në pushtet. Kjo akoma më shumë kontribuon për ndjenjën e mosndëshkimit të shkeljeve të demokracisë dhe të zbatimit ligjor të proceseve demokratike, siç janë zgjedhjet.

Gazetarët dhe mediat në përgjithësi, disa vite me radhë janë vënë nën kontroll të fuqishëm politik, ndërsa gazetaria e pavarur është në goditje të vazhdueshme, në mënyra shumë të ndryshme dhe pothuajse çdo ditë. Izolimin social, madje edhe dhunën ndaj atyre me mendim kritik, aktivitetet apo grupet etnike i nxisin gazetarët proqeveritarë në kuadër të fushatave të vazhdueshme të organizuara nga ana e pushtetit.

Ekzistojnë pohime serioze se policia dhe shërbimet për zbulim të brendshëm janë të politizuar thellë dhe janë shndërruar në shërbime të qeverisë, ndërsa në shënjestër e kanë opozitën dhe të gjithë njerëzit e organizuar me mendime kritike.

Qeveria është punëdhënësi më i madh në vend. Administrata dhe të gjithë të punësuarit e tjerë të cilët janë të lidhur ose prekur drejtpërdrejt me punën e administratës janë nën kontroll të drejtpërdrejtë dhe obligohen të zbatojnë propagandë të vazhdueshme dhe agresive, duke e kompletuar kështu fotografinë e një shoqërie dhe sistemi me kontroll të lartë. Ato subjekte komerciale të cilat nuk janë nën kontrollin/ndikimin e drejtpërdrejtë të qeverisë janë objekt i ndjekjes dhe presionit të vazhdueshëm nga ana e institucioneve financiare dhe ballafaqohen me vështirësi serioze në rast të mosrespektimit të instruksioneve politike për punësimin e ushtarëve partiakë ose ndonjë mënyrë tjetër të mbështetjes së partisë në pushtet.

Fushata e vazhdueshme politike në të cilën ofrohet garë e vazhdueshme zgjedhore publikut mjaft të painformuar është rutinë e përditshme e cila zbatohet me vite, ndërsa veçanërisht është përforcuar nga fillimi i vitit 2012. Përveç hakmarrjes politike, nuk ekzistojnë shkaqe të tjera të qarta për shpjegimin e fushatës së vazhdueshme negative në mediat kundër opozitës e cila nuk ndalon që nga zgjedhjet parlamentare paraprake.

SITUATA PARA FILLIMIT ZYRTAR TË FUSHATËS ZGJEDHORE

Llojet e tjera të detyrimeve, nga premtimet për punësim, deri te pushimi nga puna i punonjësve “të padëgjueshëm” janë praktikata e za-

konta të cilat zbatohen me vite, ndërsa veçanërisht morën hov disa javë para zgjedhjeve.

Ushtarët partiakë me kujdes e kanë vëzhguar mendimin dhe qëndrimin e njerëzve në bashkësi dhe kanë reaguar për çdo detal. Çdo lëvizje e opozitës dhe kandidatëve të pavarur të niveleve lokale ishte objekt i sulmit të ashpër me qëllim që të diskreditohej ose neutralizohet kundërshhtarët, shpesh duke përdorur gjuhën e urrejtjes.

Manipulimi dhe kanosjet me pushim nga puna ose me vizita nga policia e financave, ndërprerjen e asistencës sociale dhe mbrojtjes shëndetësore, keqpërdorimi i fëmijëve për qëllime partiake, veçanërisht në shkollë, etj. janë praktika të cilat janë vërejtur që para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore. E gjithë kjo u përforcua disa javë para fillimit të fushatës.

Vëzhguesit e Civilit kanë njoftuar se fushata e fshehur ka filluar shumë më herët në formë të anketave anonime telefonike. Këto “anketa” në kombinim me aktivitetet në terren të ushtarëve partiakë zbuluan votues të papërcaktuar dhe të dëshpëruar. Anketat e këtilla dhe aktivitetet në terren ishin masovike dhe të zbatuara në mbarë vendin, duke shkaktuar brengosje serioze për sigurinë e të dhënave personale.

Në mënyrë të shfrenuar ndërtoheshin salla sportive, terrene sportive, rrugë dhe trotuare, ndërsa përmendore dhe objekte të tjera janë promovuar pothuajse në çdo kënd të vendit, në një kontekst qartë zgjedhor. Vëllimi i këtyre operacioneve në të cilat me të madhe janë përfshirë funksionarë të pushtetit qendror, resurset shtetërore dhe lokale është shumë masovik dhe i shpeshtë. Disa raporte përmendin përsëritjen e shumëfishtë të hapjes së objektit të njëjtë, ndërsa brenda natës janë shapur edhe një numër i madh i përmendoreve.

Tubimet dhe ngjarjet publike, të cilat përfshijnë ushqim falas për të pranishmit janë intensifikuar në disa muajt e fundit para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore.

Që nga fillimi i vitit, partitë politike i kanë shfrytëzuar zyrtarët e tyre për udhëheqjen e vazhdueshme dhe intensive të fushatës.

TEMAT DOMINUESË NË FUSHATË

Zgjedhjet sillëshin rreth betejës politike midis dy partive më të mëdha etnike maqedonase dhe, edhe pse në masë më të vogël, rreth luftës së BDI-së për pushtet të plotë në sektorin etnik shqiptar në shoqërinë e Maqedonisë. Me përjashtim të Shkupit, ku çështja për projektin “Shkupi 2014” pati edhe vlerë lokale dhe kombëtare, çështjet e tjera në fushatë

ishin kombëtare, si nivelet e pagave dhe pensione, çmimi i energjisë elektrike etj.

Duket se decentralizimi, i cili lëvizte me shpejtësi e cila është shumë e madhe për institucionet e Maqedonisë për ta kapur hapin, nuk arriti në tërësi të depërtojë deri në trurin e partive politike dhe votuesve. Vlera e tij gjithsesi është relativizuar gjatë viteve të kaluara, si centralizimi dhe koncentrimi i vendosjes në një grup të vogël njerëzish të cilët e shtyejnë decentralizimin në domenin e fiksionit.

Në kontekst të shkallës së papunësisë nga më shumë se tridhjetë për qind, nuk është kurrfarë befasi që njerëzit votojnë kryesisht për ata të cilët duket se garantojnë të ardhura. E njëjta vlen edhe për disa kandidatët e pavarur të cilët u kandiduan për kryetarë komunash.

Kundrejt gjithë kësaj, në fushatë dominonte dueli midis dy liderëve, për çështjen nëse qeveria i ka plotësuar premtimet, si dhe për çështjen për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Injorimi i problemeve lokale dhe çështjeve nga ana e lidershit të lartë të partive më të mëdha materializohet në ricentralizimin gradual të vendimmarrjes, gjegjësisht refuzimin për t'u bartur fuqia e vërtetë e vendimmarrjes në nivel lokal.

Duke e pasur parasysh politizimin e administratës, zgjedhjet lokale ishin vetëm një hap më tej në përfundimin e fuqisë së koncentruar në duart e grupit të disa të përzgjedhurve, në dëm të pluralizmit të mendimeve dhe koncepteve, gjithashtu edhe në partinë e njëjtë politike. Për grupin në pushtet, zgjedhjet ishin pjesërisht stërvitje për integritet, mënyrë e zgjatjes së doktrinës dominuese deri në secilin nivel të mundshëm të administratës.

E gjithë kjo shkon dorë pas dore me kulturë të tepruar të mikro udhëheqjes dhe kontrollit të rreptë nga ana e pushtetit qendror/partive në pushtet, me çka prodhohet administratë lokale dhe përfaqësim politik të cilët janë të nënshtruar dhe të gatshëm për plotësimin e detyrave të cilat u jepen nga ana e lidershit të gjithëfuqishëm. Kjo përfshin pjesëmarrjen në zgjedhje të sofistikuar, ndërsa disa herë në mashtrime të qarta zgjedhore, siç tregon ky raport. Shumica e teknikave të cilat zbatohen për t'i fituar zgjedhjet do të ishin të pamundura pa qenë numri i madh i të punësuarve në administratë vetëm instrument në duart e liderëve politikë dhe zbatues të veprimeve mashtruese.

INTERVENIMI DEMOGRAFIK: PUSTEC

Intervenimi demografik është teknikë e vjetër në përpjekje për t'u ndryshuar një situatë e dhënë etnike apo shoqërore. Realiteti është se intervenimi i këtillë pothuajse asnjëherë nuk ka sukses. Në këtë rast, banorët e fshatrave maqedonase Pustec të Shqipërisë, janë angazhuar që të bëhet votimi masovik në komunën Qendër të Shkupit. Shkak ishte ajo që opozita pati mundësi të mëdha që të fitojë dhe u kanos se do ta ndërpresë projektin kryesor të qeverisë, gjegjësisht rirregullimin e qendrës së qytetit, i cili u bë i njohur si "Shkupi 2014".

Teknika është shpjeguar më sipër në raport. Mjafton të thuhet se ky manipulim përbante tri elemente:

1. Banorëve të Pustecit, të cilët gjoja janë bërë shtetas të Maqedonisë në disa dekadat e kaluara u është dhënë adresë e rremë në Shkup dhe letërnjoftime të rrema, disave prej tyre më shumë kohë para zgjedhjeve, ndërsa disave vetëm disa ditë para ditës së votimit;
2. U është siguruar ndihmë logjistike pasi që përndryshe nuk do të dinin ku të votojnë;
3. Ekzistojnë pohimet se çmimi për ngjarjen e këtillë nuk është aq për honorarin që e kanë marrë për këtë punë, sa për qasjen deri te sigurimi shëndetësor falas në Maqedoni.

Tri pikat e lartëshënuara e tregojnë mundësinë për operacionin e paramenduar dhe zbatuar mirë, në zbatimin e të cilave janë shkelur ligjet disa herë.

Civil mori njoftime për banorët e Pustecit me qëndrim afatgjatë dhe ligjor në Maqedoni, që automatikisht përfshin posedimin e letërnjoftimit valid në komunën ku e kanë vendqëndrimin, të cilët janë lavdëruar se kanë fituar letërnjoftimin e dytë nga Shkupi. Nëse konfirmohet se kjo gjë është e saktë, e njëjta paraqet shkelje serioze, e cila mund të zbatohet vetëm nga ana e autoriteteve të cilët janë kompetent për dhënien e dokumenteve për identifikim personal, gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme dhe njësitë e asj rajonale. Civil definitivisht do të mbetet i angazhuar në hetimin e kësaj çështjeje.

Në fund, ky operacion i paramenduar mirë dhe shokues nuk u tregua i mjaftueshëm për rikthimin e votave në qendrën e kryeqytetit. Gjegjësisht, duket qartë se pati efekt të kundërt dhe kontribuoi për mobilizimin e numrit të madh të votuesve të papërcaktuar në dobi të opozitës. Ajo që këtu është relative megjithatë është, dimension afatgjatë dhe logjistikë e sofistikuar me të cilën është zbatuar e gjithë kjo. Kjo flet ose për gjenialitetin e madh ose për nivelet e mëdha të energjisë kriminele,

ndoshta edhe për të dyja.

Shkalla në të cilën institucionet shtetërore janë shfrytëzuar për qëllime partiake, shkalla në të cilën lidhshiptari i partisë në pushtet i fiton institucionet shtetërore duhet të hetohet në tërësi. Pretendimet janë mjaft serioze dhe nuk duhet të shkruhet në një raport të këtillë se procedura për detyrën zyrtare e prokurorisë shtetërore është detyrë ligjore.

DHUNA STRUKTURE

Një listë tjetër të parregullive të cilën e vërejti Civil, siç janë votimi për tjetrin, votimi familjar, tentimet e ndryshme për fillimin e të ashtuquajturit “treni bullgar” – disa me sukses, frikësimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhore, prania e paautorizuar e anëtarëve të partive politike brenda dhe rreth vendvotimeve, mund të shiheshin si elemente të përsëritshme në traditën zgjedhore të Maqedonisë. Edhe krahas asaj që të njëjtat paraqesin shkelje, dukuria e tyre, gjegjësisht refuzimi për t’u zhdukur mund të interpretohet si rezultat i drejtpërdrejtë i nivelit të përgjithshëm të kulturës politike në vend.

Sido që të jetë, ajo që është rritur është niveli i dhunës strukturore në këto zgjedhje, trend që vërehet në disa cikle zgjedhore. Presioni mbi të punësuarit në administratë dhe në ndërmarrjet në pronë shtetërore apo private për të siguruar votues ishte më i larti deri më tani, ndërsa mekanizmat kontrolluese janë ridefinuar. Presioni mbi grupet shoqërore të marginalizuara dhe në nevojë është rritur, ndërsa janë paraqitur edhe disa shembuj të kanosjeve të drejtpërdrejta. Kategorizimi i qytetarëve si “lojalë”, “indiferentë” dhe “jolojalë” arriti dimensionet deri tani të mëdha. Prania e pjesëtarëve partiakë lojalë para vendvotimeve për identifikimin e votuesve dhe fshirja e tyre prej listave të cilat i kanë është praktikë që është rritur dukshëm. Sinjali është i qartë: nuk jeni vetëm, ju ndjekim, ju kontrollojmë, bëhuni të dëgjueshëm.

Shfrytëzimi i metodave të këtilla të frikësimit dhe manipulimit mban firmën e strukturës politike e cila është e interesuar vetëm për zbatimin e fuqisë dhe kontrollit, nëse duhet edhe në dëm të demokracisë. Ky keqpërdorim i mjeteve shtetërore dhe mungesa e dallimit midis partisë dhe shtetit janë karakteristike të sjelljeve antidemokratike.

Shkaqet se pse kjo sjellje tolerohet janë të ndryshme: së pari për shkak të kulturës politike në vend e cila akoma është në nivel shumë të ulët, ndërsa është paralel me nivelin e arsimimit. Së dyti, sistemi arsimor dhe vlerat tradicionale të shoqërisë favorizojnë sjelljen e nënshtruar kun-

drejt mendimit kritik. Së treti, dhe sigurisht më e rëndësishmja, është ajo që niveli e varësisë së njerëzve të qendrave të fuqisë është rritur në kontekst të stagnimit ekonomik. Grupet e fuqishme e kanë ridefinuar rrjetin e nepotizmit dhe klientelizmit në nivele që deri më tani ishin sjellje të panjohura në historinë e fundit të vendit.

Në disa ciklet zgjedhore të fundit është më shumë se e qartë se metodat tradicionale të arsimit zgjedhor dhe parandalimi i mashtrimeve zgjedhore nuk solli sistem zgjedhor më efikas. Ndoshta është koha për të menduar për qasje të reja dhe një sërë nismash të tjera ligjore.

LUFTË
E PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHTET

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

Fushata agresive dhe e dhunshme

Periodha zyrtare e fushatës filloi më 4 mars, sipas marrëveshjes politike, data për dorëzimin e listave të kandidatëve nga ana e opozitës u anulua për më 8 mars. Kjo është vetëm një nga shumë parregullsitë në rregullativat që i referohet vendimeve të përshpejtuara dhe mungesës së vullnetit dhe/apo kapacitetit për zbatimin e drejtë të vendimeve politike në kornizën ligjore.

Në ditët e para të fushatës zyrtare, ekipet vëzhguese të Civilit njoftuan për “fushatë të ndyrë dhe të pandërgjegjshme”. Në vazhdim është bërë përzgjedhja e ngjarjeve dhe praktikave të cilat shpresoj se do ta pasqyrojnë stilin e fushatës gjatë këtij procesi zgjedhor, ndërsa mund të cilësohen si mjaft agresive dhe të dhunshme.

Në mbrëmjen pas arritjes së marrëveshjes politike midis opozitës dhe koalicionit qeveritar me ndërmjetësimin e diplomatëve të BE-së, në mbarë vendin është distribuuar një publikim me titull “100 dështimet më të mëdha të LSDM-së” i shtypur në letër të shtrenjtë dhe me cilësi të lartë. Siç duket, publikimi është përgatitur prej më parë, në rast se opozita e kryesuar nga LSDM-ja vendos të hyjë në garë zgjedhore. Edhe krahas obligimit ligjor që të tregohet botuesi i publikimit, kjo nuk përbante të dhëna të këtitilla, edhe pse është e qartë se ishte hap i dirigjuar nga partia në pushtet. Kjo lloj fushate e ndyrë vazhdoi gjatë tërë procesit.

Kjo mënyrë e udhëheqjes së fushatës e arriti kulminacionin e saj ditën e rivotimit më 21 prill në komunën Qendër ku një sasi e madhe e pankartave me logon e kandidatit opozitar u paraqitën në rrugët dhe në kutitë postare, në të cilat pohohej se zgjedhjet do të mbahen një javë më vonë dhe në të cilat qytetarëve u është bërë thirrje të mos dalin në votim atë ditë.

Në fillim të muajit mars, partitë e koalicionit të kryesuar nga LSDM-ja kanë qenë të preokupuar me pengesat ndërpartiake për përpilimin e listave. Ndërkohë, partitë e koalicionit qeveritar dhe partitë opozitare të shqiptarëve kishin hyrë thellë në fushatë. Ata kanë organizuar konventa partiake masovike dhe tubime publike në të cilat i kanë promovuar kandidatët e tyre për kryetarë komunash. Prania e përfaqësuesve të lartë qeveritarë, ndërsa disa herë edhe e strukturave të larta religjioze, ishte dukuri e përditshme.

Pa dallim se sa është e vogël komuna, kryeministri, të gjithë ministrat dhe zëvendësit e tyre, shefat e policisë dhe figura të tjera politike dhe qeveritare, si dhe klerikët ortodoksë, dolën për t'i mbështetur kandi-

datët e tubimeve të organizuara mirë dhe të shtrenjta.

Projektet qeveritare janë promovuar nga mesi i fushatës për pushtetin lokal dhe janë prezantuar si suksese të partisë politike në pushtet.

Në shumicën e rasteve fushata u ul në nivelin personal, veçanërisht me sulmet nga ana e partisë në pushtet ndaj personalitetit dhe karrierës politike të liderit të opozitës Branko Cërvenkovski. Sulmet mbi liderin e opozitës ishin personale, të drejtpërdrejta dhe të pandershme në mënyrë deri më tani të paparë në skenën politike të Maqedonisë. Edhe pse të drejtuara personalisht kundër liderit të opozitës, ato ishin gjegjësisht tentim që të diskreditohet opozita. Në terren, ata të cilët nuk ishin në anën e partisë në pushtet janë etiketuar si tradhtarë dhe spiunë.

Më 1 mars Civil organizoi konferencë për kulturën politike dhe dialogun në të cilën u ftuan të gjitha partitë politike. Vetëm një numër i vogël i partive të opozitës e dhanë kontributin e tyre, si dhe një numër i caktuar i përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të misionëve vëzhguese kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vane Cvetanov, funksionar në partinë opozitare VMRO-PP, ish-funksionar në partinë në pushtet VMRO-DPMNE dhe ish-Drejtor në Drejtorinë për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit e shpalsi metodën në proceset zgjedhore të mëparshme nga ana e anëtarëve të ish-partisë së tij. Gjithashtu, ai i bindi të pranishmit dhe të gjithë opinionin se këto praktika janë përcaktuar mirë dhe se janë pjesë e këtij procesi zgjedhor.

Midis tjerash, Cvetanov sqaroi: “Tri ditë para zgjedhjeve qasen nga të gjithë borxhlinjtë dhe u jepet propozim për shlyerjen e borxhit, ndërsa si kundërshtim të votojnë për DPMNE-në. Për në fund, te familjet më të varfra gjendja betonohet me ndarjen e parave, prej 10 deri në 100 euro për një votë.

Dy ditë para zgjedhjeve, DPMNE e ka tabelën me votuesit e sigurt me saktësi prej 98%.

Pas gjithë këtyre operacioneve jodemokratike dhe kundërligjore, edhe e gjithë OSBE-ja të vijë në Maqedoni në ditën e zgjedhjeve nuk do të konstatojë probleme, pasi që pushteti, kohë më parë, me metodat më të vrazhda, me kanosje, kushtëzime ose blerje të votave i ka siguruar votat e nevojshme”.

Raportet e ekipeve të vëzhguesve të Civilit dhe thirrjet e shumta dhe njoftimet e qytetarëve gjatë gjithë procesit zgjedhor në masë të madhe i vërtetuan këto paralajmërime dhe konstatime.

Presioni zgjedhor

Një sërë formash të ndryshme të presionit, kanosjeve, kushtëzimeve dhe frikësimeve ishin të pranishme gjatë gjithë procesit zgjedhor, siç është vërejtur edhe nga ekipet e vëzhguesve të Civilit në periudhën nga fundi i dhjetorit 2012 deri nga mesi i majit 2013.

Në agjtitimin dhe presionin mbi qytetarët kanë qenë të involvuar përmbaues. Sipas prononcimeve, përmbauesit në mënyrë selektive kanë vepruar me urdhëresat e gjykatës për t’i paguar gjobot e papaguara. Sipas njërit prej raporteve, në komunën Shuto Orizare, Samka Ibraimovskit, funksionar i PEPR (Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve) dhe deputet në kuvend, i është konfiskuar pronë për shkak të orientimit të tij politik, gjegjësisht mbështetjen e opozitës.

Në një numër të madh komunash qytetarët janë ankuar për format e ndryshme të presionit dhe mbjelljes së frikës. Sipas tyre, njerëzit janë kontrolluar në mënyra më të ndryshme, duke filluar nga komunikimi i tyre, deri në ndjekjen e tyre nga ana e ushtarëve partiakë. Prononcime të këtilla janë notuar në shumicën e komunave të Qytetit të Shkupit, në komunat Prilep, Tetovë, Jegunoc, Gjevgjeli, Veles etj.

Pavarësisht faktit se kjo frikë është e pabazë, vetë mendimi se njeriu është i vëzhguar është simptomatik dhe flet për përpjekjen e suksesshme për krijimin e atmosferës së përgjithshme të presionit dhe kontrollit.

Në komunat Mavrovë dhe Rostushe, presioni është bërë mbi shfrytëzuesit e bursave të studimit në Universitetin FON që të jenë aktivë gjatë fushatës dhe të agjitojnë për PIE (Partinë për Integrim Evropian). Në nivel kombëtar kjo parti ishte në opozitë, por pati marrëveshje joformale me BDI-në në nivel lokal, në këmbim për mbështetje në Strugë.

Partia kryesore opozitare LSDM akuzoi për maltretimin e anëtarëve të tyre të cilët janë të punësuar në institucionet publike në nivelin lokal dhe qendror.

Sipas disa prononcimeve të caktuara, anëtarët e VMRO-DPMNE-së nga Radovishi të cilët kanë qenë në funksione udhëheqëse në qendrat për punë sociale, në fondin për sigurim pensional dhe shëndetësor dhe në qendrën për punësim u janë kanosur shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre se do t’ua ndërpresin të njëjtat nëse nuk votojnë për VMRO-DPMNE-në.

Deri te ekipet për vëzhgim të Civilit arritën njoftimet nga qytetarët të cilët kërkuan të mbeten anonimë, sipas të cilëve në komunën e Velesit, përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së kanë përpiluar një listë të kompanive “të sigurta” dhe subjekteve tregtare të cilëve u është premtuar se nuk

do të vizitohen nga policia financiare në katër vitet e ardhshme në këmbim të mbështetjes së tyre dhe votave të tyre.

Një piceri në Gjevgjeli është mbyllur dhe i është shqiptuar gjobë në lartësi prej 3.000 eurove pasi që ka qenë nikoqire e aktivistëve të opozitës, bëhet e ditur nga deklarata e njërit prej të punësuarve në piceri. Më 19 mars në Jegunoc gjatë një mbikëqyrjeje inspektuese është mbyllur mensa e fabrikës Jugohrom në pronë të një anëtarit të LSDM-së. Ka informata edhe se një kafe-bar i hapur në Jegunoc është dënuar me gjobë në shumë prej 1.000 euro, pasi që pronari është parë se si ka marrë pjesë në mitingun e opozitës. Është shndërruar në incident për të cilin është dashur të intervenojnë njësitë speciale.

Sipas disa prononcimeve të caktuara, në fshatin Trebishte (Mavrovë dhe Rostushë), disa funksionarë lokalë të VMRO-DPMNE-së kanë bërë presion mbi një biznesmen lokal që t'u sigurojë 50 vota, në të kundërt biznesi i tij do të mbyllet, ndërsa objekti i tij afarist do të demolohej si ndërtime të paligjshme.

Sipas një burimi të PDSH-së, më 21 mars kandidatët për këshilltarë komunal të BDI-së kanë bërë presion mbi rastet sociale në fshatrat e rajonit të Tetovës që të votojnë për BDI-në (në disa prej fshatrave populata e kategorive sociale arrin numër edhe prej 80%).

Sipas prononcimeve të qytetarëve, kandidatët e VMRO-DPMNE-së në Veles dhe në Berovë kanë shkuar derë në derë dhe u janë kanosur njerëzve se do ta humbin asistencën sociale nëse nuk votojnë për partinë e tyre.

Sipas thirrjeve telefonike dhe deklaratave që u janë dhënë ekipeve vëzhguese të Civilit, aktivistët e VMRO-DPMNE-së në Berovë janë kanosur se do të ndërpriten furnizimi me ujë i familjeve rome nëse nuk votojnë për partinë e tyre.

Në paraqitjet e marra për komunat Kratovë, Shtip, Radovish dhe Qendër (Shkup) pohohet se qendrat për punë sociale u janë kanosur shfrytëzuesve të asistencës sociale se e njëjta do t'u ndërpritet nëse nuk votojnë për partinë në pushtet.

Blerja e votave

Kryesisht, blerja e votave ishte e pranishme kudo dhe në forma dhe përmasa të ndryshme. Civil ka të dhëna dhe informacione më të thukta për atë se si janë blerë votat përmes formave të ndryshme të keqpërdorimit të institucioneve dhe fuqisë institucionale. Prononcimet

dhe paraqitjet janë notuar nga ekipet vëzhguese të Civilit në njëqind raste. Blerja e votave është bërë në mënyra të ndryshme. Falas janë dhënë letërnjoftime, vonimi i ndihmës shtetërore ishte i qëllimshëm, dënimet me burg janë shkurtuar, u është ofruar lirimi i pagesës së gjobave për komunikacion dhe shkelje të tjera, më pas, para, ushqim, veshje, prodhime bujqësore dhe të mira të tjera, janë paguar faturat për shërbime komunale dhe borxhet në shitoret në këmbim të votave.

Blerja e votave është praktikë e përcaktuar mirë e partive politike dhe është e pranishme në të gjitha proceset zgjedhore në vend deri më tani. Këto zgjedhje nuk bënë përjashtim.

Vëzhguesit e Civilit nënvizuan se ndarja e ushqimit dhe prodhimeve të tjera është e pranishme në mënyrë masive. Thasë me miell (deri në 25 kilogramë), prodhime higjienike dhe veshje u janë ndarë qytetarëve të varfër në vend, veçanërisht në mëhallat rome.

Nëpër fshatrat në shumë komuna, aktivistët e VMRO-DPMNE-së kanë shpërndarë ushqim dhe repromateriale bujqësore.

Gjatë ditëve para raundit të parë të zgjedhjeve, familjeve rome dhe të varfra në Veles dhe Kratovë u janë shpërndarë dru për ngrohje dhe vaj ushqimi.

Në Gjevgjeli, nga tri kamionë plotë me prodhime (ushqim, miell dhe vaj ushqimor) u është shpërndarë ushqim disa votuesve të "papërcaktuar" në 72 orët e fundit para ditës së zgjedhjeve.

Në një numër të madh rastesh janë evidentuar forma të veçanta të blerjes së votave në kombinim me shfrytëzimin e resurseve shtetërore. Për shembull, pensionistët morën tre tretmane falas në banjë. Keqpërdorim më serioz ishte rasti në të cilin, sipas raportit nga terreni, të burgosurve u është ofruar ulje e dënimit me burg të cilin e kanë vuajtur në burgun në Tetovë. Sipas raporteve të ekipeve për vëzhgim të Civilit, në disa komuna në pjesën lindore të vendit qendrat për punë sociale kanë dhënë vërtetime me të cilat personat të cilëve u janë dhënë janë liruar nga pagesa e çfarëdo kompensimi për shërbimet shëndetësore. Institucionet janë shfrytëzuar edhe si mjet për blerjen e votave në mënyra të ndryshme. Ja edhe disa shembuj të ndryshëm.

Ekzistojnë pohime se 35 votuesve të kombësisë rome nga Vinica u është premtuar se falas do të marrin letërnjoftim në këmbim për votën e tyre për VMRO-DPMNE-në.

Qeveria shfrytëzoi një helikopter që ta vizitojë rajonin e Strumicës gjatë vërshimeve në shkurt, por premtimet për dëmshpërblim janë plotësuar vetëm disa ditë para zgjedhjeve (një muaj më vonë). Gjoja, kompensimi për dëmin është ofruar në mënyrë selektive, për votuesit "e sigurt" të VMRO-DPMNE-së, duke ju theksuar në këtë mënyrë të tjerëve se cili

është çmimi të cilin duhet ta paguajnë që të marrin ndihmë. Më 21 mars, këshilli i komunës së Velesit ka mbajtur seancë urgjente për përcaktimin e kompensimit të dëmit për familjet që kanë pësuar humbje materiale gjatë vërshimeve dhe përsëri kjo është për votuesit e “sigurt” të VMRO-DPMNE-së.

Sipas raporteve në terren, përjashtim nga kjo praktikë nuk ishin kandidatët opozitarë. Sipas disa njoftimeve, Zoran Damjanovski, kryetari i atëhershëm i Kumanovës dhe kandidat për edhe një mandat, ka bërë një gjest të tillë. Ai të gjitha klubeve futbollistike në komunë u ka dhuruar pajisje sportive të markës “Najk”. Dega komunale e VMRO-DPMNE-së në Koçan ka lajmëruar në polici se LSDM-ja u ofron para votuesve. Rasti është evidentuar nga ana e policisë. Nuk ka rezultate për të njëjtën.

Sipas pohimeve të qytetarëve të cilët kanë kontaktuar me vëzhguesit e Civilit, në ditët para ditës së zgjedhjeve, bashkë me ditën e heshtjes parazgjedhore, ish-kryetari i Tetovës (PDSH) ka bërë pagesa avance për nevojat teknike të lagjeve, duke i kërkuar votat e tyre. Në Gostivar të gjitha partitë më të mëdha politike kanë ndarë ushqim dhe u kanë paguar faturat e shërbimeve komunale (energjinë elektrike, ujën etj.) familjeve të varfra.

Në ditën e zgjedhjeve, 24 mars, blerja e votave ishte e pranishme kudo. Kishte informacione për ndarjen e parave, ushqimit dhe prodhimeve të tjera në Prilep (veçanërisht në lagjen Varosh). Çmimi për një votë në Manastir ishte midis 300 dhe 500 denarë në mëngjes, por gradualisht është rritur ashtu siç ka kaluar dita. Në Kratovë janë vërejtur kamionë prej të cilëve janë ndarë prodhime për familjet e varfra.

Në Resnjë, më 23 dhe 24 mars, gjatë heshtjes parazgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve, aktivistët e VMRO-DPMNE-së u kanë ofruar para anëtarëve të bashkësive më të vogla etnike në komunë (shqiptarë, turq, romë, egjiptianë). Çmimi për një votë ishte midis 200 dhe 3.000 denarë. Në Pillasnicë kandidati i BDI-së u ka ofruar deri në 6.000 denarë votuesve para ditës së zgjedhjeve. BDI ka premtuar para dhe punësime votuesve në komunën e Çairit ditën para zgjedhjeve.

Sipas vëzhguesve të Civilit, në ditën e zgjedhjeve në Kërçovë dhe në disa komuna të tjera, aktivistët e VMRO-DPMNE-së i kanë paguar borxhet që familjet rome i kanë pasur në shitoret e vogla. Në komunën e Likovës, thuhet, edhe BDI edhe PDSH u kanë ofruar para votuesve në ditën e zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve është shpërndarë ushqim në Kriva Pallankë.

Në Vevçan, në afërsi të ndërtesës komunale ku është zhvilluar votimi, vëllai i kandidatit për kryetar të VMRO-DPMNE-së ka vendosur stendë në të cilën falas u ka ndarë zgarë votuesve. Më vonë Civil mësoi se kom-

pania ndërtimore e cila e ka ndërtuar portën Vevçani gjatë fushatës zgjedhore, gjithashtu, e shfrytëzuar si vegël në fushatë për “shënimin e territorit”, për të treguar efikasitetin në ndërtimtari dhe nxitjen e turizmit në komunë, është pronë e familjes së kandidatit për kryetar komune. Porta ishte veçanërisht e kontestuar në mesin e popullatës të fesë myslimanë në komunë.

Sipas informacioneve deri te të cilat erdhën vëzhguesit e Civilit, në lagjen Peshtani të Ohrit, aktivistët e VMRO-DPMNE-së kanë grumbulluar letërnjoftime të qytetarëve që t’i evidentojnë në listat e tyre të votuesve “të sigurt” dhe u kanë ofruar para votuesve gjatë fushatës parazgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve në komunën e Dojranit votuesve u është ndarë sheqer, miell dhe para. Një situatë e ngjashme është vërejtur edhe në Vinicë: në mbrëmjen në pritje të ditës së zgjedhjeve, votuesve u është ndarë miell, ushqim, vaj ushqimor, dru për ngrohje dhe para. Vazhdimisht në Vinicë kanë qarkulluar automjetet zyrtare të pushtetit qendror dhe lokal.

Në Shtip, votuesit romë janë këshilluar me njëri-tjetrin “të mos votojnë për ata të cilët nuk paguajnë”. Nuk ishte e qartë se kush paguan, ndërsa kush nuk paguan, por u bë e qartë se blerja e votave është e pranishme. Gjithashtu, mësuam se në fshatin Banicë, komuna e Strumicës, aktivistët e VMRO-DPMNE-së votuesve u kanë ofruar midis 1.200 dhe 6.000 denarë. Në ditën e zgjedhjeve, prodhime në vlerë midis 1.000 dhe 3.000 denarë u janë ndarë personave të popullsisë rome në Tetovë nga ana e BDI-së dhe PDSH-së. Informatat thonë se rreth 100 persona e kanë pranuar këtë ofertë.

Gjatë heshtjes parazgjedhore në Kavadar votuesve u janë paguar faturat për energji elektrike dhe u janë paguar deri në 200 euro për familje dhe u janë ndarë dru për ngrohje. Në të njëjtin qytet, 30.000 denarë i janë dhënë prej përpara një shitoreje lokale që “t’u japë të hanë dhe të pinë” votuesve, siç deklaroi personi që ka paguar, për të cilin beson se është aktivist i VMRO-DPMNE-së.

Sjellje e dhunshme

Për dallim nga dhuna e përhapur strukturore dhe barazimi i shtetit me partinë, përdorimi i dhunës fizike dhe të armatosur ishte më shumë se sporadik. Megjithatë vëzhguesit e Civilit dhe organizatat partnere kanë evidentuar një numër të caktuar të incidenteve. Në vazhdim bëjmë përzgjedhjen e disa prej tyre.

Më 19 janar, kryetari i komunës Karbinci fizikisht ka sulmuar një të ri – mbështetës i LSDM-së opozitare. Kur viktimja e ka paraqitur incidentin në polici, kryetari i komunës në kishë është betuar publikisht se nuk e ka sulmuar këtë person. Mediat e transmetuan mohimin publik të akuzës. Një nëpunës policor, gjoja, ka kryer presion mbi viktimën që t'i tërheqë akuzat. Pavarësisht asaj sa është absurde kjo situatë, ajo e pasqyron nivelin e kulturës politike dhe përdorimin e religjionit si vegël për bashkim. Sipas prononcimeve të qytetarëve dhe vëzhguesve të Civilit, aktivistët e opozitës janë sulmuar nga aktivistët e VMRO-DPMNE-së dhe anasjelltas, mbi 20 herë në mbarë vendin, por pa pasoja serioze. Shumë prej këtyre incidenteve më të vogla nuk janë paraqitur në polici.

Në shkurt, punonjësit komunalë nga parti politike kundërshtarë kanë pasur zënkë fizike në Tetovë.

Edhe në muajin mars janë evidentuar disa incidente. Ka shpërthyer zënkë midis vizitorëve në një klub nate në Resnjë, me gjasë midis mbështetësve të LSDM-së dhe mbështetësve të kandidatit të pavarur, Dimitar Buzlevski (ish-anëtar i LSDM-së). Në Koçan, një kandidat për këshilltar nga LSDM-ja ka sulmuar një mbështetës të VMRO-DPMNE-së. Në Gjevgjeli, një grup mbështetësish të VMRO-DPMNE-së i kryesuar nga shefi i komitetit komunal të partisë kanë sulmuar një mbështetës të LSDM-së i cili ka qenë vetë.

Më 16 mars, në klubin e natës “Mistik” në Shtip, ka ndodhur rrahje midis mbështetësve të VMRO-DPMNE-së dhe atyre të LSDM-së. Gjoja në rrahje janë involvuar djali i liderit të opozitës, Branko Červenkovski dhe njëri nga biznesmenët lokalë – mbështetës i opozitës. Autobusët e partisë Rilindja Demokratike Kombëtare janë gjuajtur me gurë në Shkup duke u kthyer nga konventa partiake më 2 mars.

Sipas vëzhguesve të Civilit, shtabet zgjedhore pothuajse të të gjitha partive politike në mbi 30 lokacione në vend janë dëmtuar ose demoluara. Prishja e rendit dhe qetësisë publike, përfshirë edhe parakalimet dhe boritë e automjeteve, ishin pjesë e pakalueshme e mitingjeve të partive politike kudo. Disa qytetarë u ankuan për zhurmën dhe papastërtinë të cilën partitë e lënë pas vetes.

Përdorimi i armëve

Përdorimi i armëve ishte sporadik dhe ato kryesisht u përdoreën për të festuar. Edhe krahas asaj që Ligji për armë i ndalon rreptësisht të shtënat për të festuar, kjo mbetet si shprehje që po stërzgjetet. Të shtënat janë vërejtur mbi 50 herë, edhe atë në disa komuna në Shkup, më pas në Kumanovë, Kërçovë, Resnjë, Tetovë etj.

Civilë, por edhe nëpunësit policorë në Resnjë, sipas disa njoftimeve, i kanë shfrytëzuar armët e tyre zyrtare për të shënuar fitoren pas përfundimit të raundit të parë të zgjedhjeve.

Akoma mbetet e hapur çështja për posedimin e armëve nga ana e agjencive private për sigurim dhe për mënyrën në të cilën ata i shfrytëzojnë armët në fushatat zgjedhore. Kjo çështje është me rëndësi të veçantë, duke i pasur parasysh lidhjet e afërta midis partive dhe agjencive private për sigurim në vend.

Punimet ndërtimore dhe investimet – instrumente të fushatës

“I gjithë vendi është shndërruar në një kantier ndërtimi”, vërejtje e shpeshtë e qytetarëve në tërë vendin.

Kryeministri dhe përfaqësuesit e lartë qeveritarë të cilët kudo i mbështetën kandidatët e partisë në pushtet sqaruan në prezentimet dhe fjalimet publike se Qeveria do të vazhdojë me punimet ndërtimore dhe investimet në komunat në të cilat do të fitojnë kandidatët e tyre. Me fjalë të tjera, nëse njerëzit dëshirojnë që të hapen vende pune dhe të sillen investime në komunat e tyre, duhet të votojnë për kandidatin e partisë në pushtet. Në të kundërt, ta harrojnë këtë gjë. Ky mendim ishte pjesë e qëndrimit të aktiviteteve në terren të partisë në pushtet. Punimet ndërtimore kryesisht janë kryer në emër të Qeverisë, gjegjësisht të partive në pushtet në bashkëpunim të afërt me drejtoritë lokale të partisë/partive të njëjta.

“Lopatat” dhe “prerja e shiritit” janë shprehje të përhapura të ngjarjet të cilat e shënojnë fillimin e punimeve ndërtimore për rrugët dhe trotualet, hallat sportive, shkollat, unazat dhe vende të tjera publike dhe objekte të cilat (kryesisht) janë të financuara ose me bashkëfinancim nga Qeveria.

Me afrimin e ditës së zgjedhjeve u shpeshtuan ngjarjet si këto. Edhe krahas përpjekjeve për regjistrimin e aktiviteteve ndërtimore gjithëpërfshirëse në procesin zgjedhor, ekipet për monitorim dhe analistët e Civilit u ankuan se nuk kanë mundur të informohen për ngjarjet për arsye se kanë qenë në numër të madh.

Pati edhe situata komike. Për këtë raport zgjodhëm dy: Funkionarët e VMRO-DPMNE-së, me mbështetjen e ndërmarrjes publike “Shtipion”, përsëri dhanë premtimin për projektin shekullor për ndërtimin e 86 barakave për familjet rome në Shtip. Në fshatin Çelopek i Poshtëm BDI-ja, partnere në koalicionin qeveritar, në gjysmën e parë të marsit përsëri e filloi ndërtimin e shkollës fillore e cila filloi në vitin 2011 dhe menjëherë u ndërpre.

Nga mesi i marsit filloi rinovimi në dy kopshte në komunën e Aerodromit (Shkup) që zgjati deri në ditën e zgjedhjeve dhe më pas vazhdoi.

VMRO-DPMNE dhe një numër i caktuar i qytetarëve u ankuan për aktivitetet ndërtimore të kryetarit të Tetovës (PDSH) gjatë ditëve të fundit para zgjedhjeve, i cili, sipas prononcimeve, nuk ka bërë asgjë në mandatin katërvjeçar.

Kudo në vend janë vendosur trotuare, janë rregulluar rrugë dhe rrugë lokale – nga fshatrat deri në qytetet dhe qendrat e qytetit. Pati punime ndërtimore të mëdha të cilat shpesh e kanë penguar komunikacionin. Hapësira publike është dekoruar kryesisht me mbjelljen e barit dhe luleve dhe vendosjen e rrethojave zbukuruese.

Veçanërisht projekti kontrovers dhe i shtrenjtë “Shkupi 2014” vazhdoi të zhvillohet 24 orë, gjatë ditëve të punës, për fundjava dhe festa kombëtare. Natën pas ditës së zgjedhjeve të 7 prillit në qendër të Shkupit u vendosën befaz 36 skulptura dhe përmendore.

Punësime zgjedhore

Punësimet dhe largimet nga puna në masë të madhe janë përdorur si mjet për t’i bindur njerëzit që të votojnë për një apo tjetër opSION nga konkurrenca zgjedhore. Ofrojmë një pjesë të raporteve dhe deklaratat të mbledhura nga ekipet e monitorimit në gjithë vendin. Vendet e punës, pavarësisht a bëhet fjalë për fitimin apo humbjen e tyre, kanë qenë argument i shpeshtë i pushtetmbajtësve në nivel lokal, por edhe qendror.

Shumica prej atyre të cilët i janë ekspozuar manipulimit dhe/apo kërcënimit të tillë kanë thënë se punëdhënësit (institucionet lokale apo shtetërore dhe përfaqësuesit politikë, por edhe pronarë të ndërmarrje-

ve private të afërta me njërën nga pushtetmbajtësit) kanë kërkuar për tyre që të sigurojnë numër të caktuar të votave. Është dashur të përgatisin të ashtuquajtura “lista garantuese” të votuseve në favor të partisë në pushtet, të cilët është dashur t’i gjejnë.

Qeveria dhe pushtetet lokale kanë hapur shumë vende pune në dy muajt e fundit me qëllim që ta rrisin popullaritetin dhe gjasat për fitore në zgjedhjet lokale. I tillë është shembulli me komunën Veles në të cilën në fillim të muajit mars kishte punësime në ndërmarrjet publike dhe administratë. Në Kavadar personave të moshës mbi 55-vjeçare u është premtuar vend pune në këmbim për votë.

Ekzistojnë pohime edhe për përzierjen e partisë qeverisëse në sektorin tregtar. Miniera “Topanica” në Kriva-Pallankë ka fituar listë me aktivistë të partisë në pushtet të cilët udhëheqësia e minierës është dashur t’i punësojë deri më 1 mars si pjesë e premtimeve zgjedhore për punësim. Në Ohër, Strugë, Karposh, Shtip, Resnjë, Kumanovë dhe komuna tjera janë vërejtur largime nga puna apo kërcënime me largim nga puna të atyre të cilët kanë refuzuar të votojnë për partinë qeverisëse në nivel lokal apo qendror. Është regjistruar një rast në Strugë ku një anëtar i PD-SH-së menjëherë është pushuar nga puna sepse nuk ka votuar për BDI-në. Ekzistojnë informata se kryetari i komunës së Karposhit në Shkup Stevçe Jakimovski, ka pushuar nga puna dy avokatë dhe ka degraduar të tjerë apo i ka privuar nga mjetet komunikuese zyrtare (telefonë, kompjuterë) pasi që e braktisi LSDM-në dhe vendosi të kandidohet si kandidat i pavarur për kryetar komune.

Më 12 mars deputetja Vesna Bendevska nga LSDM-ja akuzoi për manipulime me punësime në institucionet publike të Manastirit. Ekipet për monitorim të Civilit në Novaci dhe Mogilla (komuna e Manastirit) erdhën deri te pohimet për presion mbi punëtorët e Kombinit të Minerave dhe Energjetikës - Bitolla që të votojnë për VMRO-DPMNE. Në të kundërtën, do t’i humbin vendet e punës.

Qytetarë nga komuna e Jeguncit deklaruan se punëtorët në fabrikën Jugohrom kanë qenë nën presion të madh. Udhëheqësia e fabrikës dhe aktivistë të VMRO-DPMNE-së i kanë vizituar në shtëpi për t’ua bërë të qartë se do t’i humbin vendet e punës në qoftë se opcioni qeverisës nuk arrin ta ruajë pushtetin lokal.

Vendimet kontestuese të Gjyqit Administrativ dhe Këshillit Shtetëror Zgjedhor

Procesi zgjedhor u shoqërua me lëshime serioze institucionale si rezultat i presioneve politike dhe partiake. Kontestuese është puna e institucioneve më të rëndësishme, Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe Gjyqit Administrativ. Vendimet e këtyre dy institucioneve dukshëm janë të bazuara mbi interesat partiak dhe etnike dhe në numër të caktuar të rasteve edhe anashkalojnë sundimin e ligjit. U refuzuan pothuajse të gjitha ankesat për parregullsi të dorëzuara nga opozita, përderisa, shumica e ankesave nga partia në pushtet u miratuan, pavarësisht rëndësisë së ankesave të njëjës apo tjetrës palë. Llogaritet se këto dy institucione kontribuan për fitoren e partive qeverisëse në komunat në të cilat opozita kishte përparësi në rrethin e parë zgjedhor.

Në mënyrë të ngjashme zgjidhjet e KSHZ-së dhe vendimet e Gjyqit Administrativ në rastet me komunat Kërçovë dhe Strugë i nxitën tensionet etnike veçmë të ndezura. Kishte manovra politike dhe hapa të paqartë në kornizat juridike për të fituar dominim etnik. KSHZ dhe Gjyqi Administrativ lejuan ekzistimin e koalicioneve të papritura me prejardhje etnike maqedonase në Kërçovë dhe Strugë me qëllim të dukshëm për dominim mbi kandidatët me prejardhje etnike shqiptare përkundër vendimit të komisioneve zgjedhore të komunës. Partitë me prejardhje etnike maqedonase, LSDM dhe VMRO-DPMNE, të udhëhequra nga motive etnike, e tejkaluan rivalitetin e ashpër politik dhe u pajtuan që të kenë kandidatët të përbashkët për kryetarë komune dhe lista të përbashkëta për këshilltarë. Me anashkalimin e kornizës ligjore dhe parimeve, dy institucionet e lartpërmendura kontribuan për rënien e mëtutjeshme të kulturës politike dhe humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet zgjedhore, si dhe gjyqësinë. U bë precedent delikat me çka u forcua dominimi i domenit politik mbi atë të drejtësisë dhe në atë mënyrë u shtua luhatja autokratike në shtetin zgjedhor i cili tashmë është i luhatur.

Keqpërdorimi i administratës dhe resurseve publike

Kishte keqpërdorim të madh të administratës publike dhe resurseve publike. Është e pamundur të numërohen të gjitha rastet dhe mënyrat e këtij abuzimi. Vërejtjet në vijim janë pjesë e materialit të gjërë të cilin e pranuan nga vëzhguesit e Civilit për keqpërdorimin e administratës publike dhe resurseve politike.

Nga fillimi i shkurtit aktivistët e VMRO-DPMNE-së të punësuar në administratën publike në nivel lokal haptazi kanë agjitur në favor të partisë së tyre duke e llogaritur atë si sjellje të zakonshme (shumë raporte nga pothuajse të gjitha komunat në vend). Kanë pasur për detyrë të përgatisin listë të votuesve të “sigurtë” (dhjetë apo më shumë votues). Kanë qenë të koordinuar, udhëzuar dhe kontrolluar nga udhëheqësitë në institucionet ku punojnë.

Të punësuarit në administratën publike kanë qenë masovikisht të kyçur në aktivizëm përmes internetit dhe fushatave telefonike.

Sipas pretendimeve në raportet nga shumë komuna, duke filluar nga marsi një pjesë e të punësuarve në administratën publike nuk kanë shkuar në punë. Në vend të kësaj kanë punuar në zyrat zgjedhore gjatë kohës së punës. Të tjerët i kanë shfrytëzuar zyrat dhe vendet e punës për zhvillimin e aktiviteteve të fushatës në favor të partisë qeverisëse në komunën e tyre apo në favor të koalicionit qeverisës në nivel qendror. Kanë shfrytëzuar celularë zyrtarë për dërgimin e porosive deri te votuesit, makina për transportimin e materialeve partiake. Në favor të partisë qeverisëse në nivel lokal dhe qendror janë shfrytëzuar edhe objekte dhe resurse tjera publike. Resurset për qëllime partiake i kanë përdorur edhe persona të paautorizuar.

Mjekët kanë agjitur te pacientët, profesorët te nxënësit dhe prindërit e tyre, punëtorët socialë te shfrytëzuesit e ndihmës sociale.

Votuesit e pacaktuar kanë qenë nën presion veçanërisht të lartë. Kup-tuam se disa të punësuar në administratën publike janë grindur për votuesit e pacaktuar, për atë se cili do të jetë në listën e votuesve “të sigurt” të cilët kanë qenë të obliguar t’i dorëzojnë deri te eprorët.

Ueb-lokacionet e komunave në të cilat kryetarët e komunave janë kandiduar për mandat të ri janë shëndrruar në resurse për fushatë.

LSDM ka puhuar se VMRO-DPMNE shfrytëzon objektet publike për mbledhje partiake.

Ka disa pohime për atë se Qeveria me financa publike ka paguar transportin e numrit të madh të përkrahësve në tubimet publike në vend.

Në erkanet e autobusave publikë në Shkup janë emetuar fjalime të kryeministrit Gruevski.

Shefat dhe eprorët e policisë haptazi kanë agjituar në Zërnovci, Zele-nikovë, Tetovë, Gostivar, Ohër dhe shumë vende tjera.

Kryetari i komunës dhe kandidati i pavarur i komunës Haračinë ka deklaruar se ai dhe përkrahësit e tij kanë qenë nën presion të madh nga partneri në kolaicionin qeveritar, BDI dhe nga administrata.

Kandidatët e pavarur

Sipas raporteve tona, kandidatët e pavarur ishin nën presion të fortë nga partia qeverisëse dhe partitë më të mëdha opozitare (për shembull, BASTRI Bajrami), veçanërisht ata nga opozita të cilët vendosën të kandidohen para se të tërhiqet vendimi për bojkotimin e zgjedhjeve (Stevço Jakimovski në Karposh, Dimitar Buzlevski në Resnjë).

Abuzimi i të miturve

Personeli i administratës publike ishte i detyruar të marrë pjesë në tubimet e VMRO-DPMNE-së gjatë dhe pas kohës së tyre të punës. Në qoftë se nuk kanë mundur të marrin pjesë, për të njëjtit ka qenë e duhur të gjejnë person i cili do t'i zëvendësojë; në të kundërtën janë përballë me largime nga puna. Vëzhguesit tanë dhe numër i caktuar i qytetarëve e informuan Civilin për sjellje të tillë nga ana e VMRO-DPMNE-së.

Pjesëmarrësit në këto tubime partiake kanë fituar nga 500-1000 denar para të gatshme për të marrë pjesë në ngjarjet e tilla. Burrimet financiare për këto pagesa mbeten të paqarta.

Të miturit pa përjashtim janë shfrytëzuar gjatë fushatës. Ata kanë bërë shpërndarjen e materialeve partiake për fushatën, kanë vendosur flamuj partiak në shkolla dhe në vende tjera publike, kanë vizituar tubime, dhe i kanë ndihmuar presonelit në hapësirat e përcaktuara për fushatë të partive politike. Në numër të madh nga zyrtarët partiake janë të verjtura kushte nën standard: të njëjtat kanë qenë të ftohta, pa ajrosje, njerëzit shpesh kanë pirë duhan brenda- dhe definitivisht nuk janë vend për të miturit.

Pjesëmarrësit nga shkollat fillore dhe të mesme nga i gjithë vendi kanë qenë të liruar nga orët e mësimi nga disa ditë që të munden me turnetë

e organizuara me autobus të vijnë dhe të marrin pjesë në tubimet dhe mbledhjet partiake. Arsimitarët dhe drejtorët ishin përgjegjës për “ekskurzionet” e tilla.

Kandidatët e VMRO-DPMNE-së dhe zyrtarët e qeverisë i vizitonin shkollat gjatë orëve të mësimi për të kryer agjitim mes nxënësve. Autobusët shkollorë ishin të mbuluar me posterë nga partia qeverisëse. Numrat e telefonit nga nxënësit, të marrë nga dokumentet për regjistrimin e nxënësve, janë shrytëzuar për agjitim të prindërit e tyre.

Marrëdhëniet ndëretnike

Marrëdhëniet etnike kishin rol të rëndësishëm në këtë proces zgjedhor. Votimi përsëri, si edhe në zgjedhjet e mëparshme, ishte i ngritur në nivel të nderit dhe obligimit kombëtar në të dy anët, maqedonase dhe shqiptare.

Këto ishin zgjedhjet e para lokale në komunën e sapodisenjuar të Kërçovë. Në të dy rrahët, mijëra shqiptarë kërçovarë të cilët jetojnë jashtë shtetit erdhën për t'u siguruar se Kërçova do të fitojë kryetar komune shqiptar. Administrata qeveritare u përgjigj me numër të madh të opstruksioneve. Sipas një burimi nga administrata qeveritare i cili bisedoi me Civilin, në numër të caktuar të rasteve, fluturime me shqiptarë etnikë ishin të ndaluar dhe aterimi i tyre nuk lejohej. Sipas burimit të njëjtë, në kohën e artitjes së aeroplanëve me “diasporën”, kishte informata për dy kërcënime të rrejshme me bombë në aeroportin e Shkupit.

Kandidati i zgjedhur, përfaqësues i BDI-së qeverisëse dhe ish-anëtar i UÇK-së, bëri gjithçka për të shfrytëzuar këtë valë të entuziazmit kombëtar. Në anën “tjetër”, VMRO-DPMNE me liderin e saj dhe kryeministrin e shtetit, zhvillonte fushatë të ashpër me karakteristika të fuqishme nacionaliste.

Në Strugë, pyetja për kauzën nacionale shqiptare ishte të mbahet komuna me çdo kusht. Për këtë shkak, BDI dhe partitë tjetra më të vogla e mbështetën PDSH-në, pasi që kuptuan se do ta humbin pushtetin në këtë komunë.

Ekipi i liderit të partisë VMRO-DPMNE, kryeministrit Gruevski, artificialisht bëri koalicion me rivalin e tij LSDM-nn, propozuan nga një kandidat dhe lista të përbashkëta këshilltarësh në të dy komunat. Të dy partitë, por veçanërisht ajo në pushtet, u përpoqën të minimizojnë çështjen dhe t'ia shesin opinionit si çështje të pjekurisë demokratike. Koalicioni etnik maqedonas nuk arriti të sigurojë vendin e kryetarit të komunës në asn-

jërën nga dy komunat.

Ky episod krijoi edhe një precedentë dhe edhe njëherë i zbuloi mangësitë e sistemit politik maqedonas, de fakto binacional, në të cilin është e natyrshme aspekti etnik të diktojë sjelljen politike, më shumë se sa ideologjia. Në qoftë se ekzistojnë, dallimet ideologjike kontestohen në kuadër të kufijve të grupit etnik, kurse disiplina e grupit etnik mbizotëron në rivalitetin me “tjetrin”. Me fjalë të tjera, prevalenca e supozuar i grupit etnik mbizotëron mbi cilat do dallime ideologjike. Kjo tendencë, sado që t’i sigurojë të drejtat e grupit, i shkakton dëm lirisë individuale të zgjedhjes dhe atë, individin, e ekspozon në presion të madh nga grupi.

Institucionet ligjërish të pavarura ishin nën presion të madh politik dhe të instrumentalizuara për të arritur rezultatet e parashikuara. Në këtë rast konkret, komisionet zgjedhore të komunës në Kërçovë dhe Strugë fillimisht votuan kundër formimit të listave etnike, mirëpo këto vendime ishin të refuzuara nga ana e Gjyqit Administrativ dhe KSHZ-së, me çka u kontribua drejt konfuzionit juridik dhe humbjes së re të pavarësisë së jurisprudencës.

Zgjedhjet lokale nuk duhet të jenë për mbizotërim etnik, por për ofrimin e zgjidhjeve më të mira për problemet lokale. Në këtë kontekst, si dhe në kontekstin e regjistrimit e pasukseshëm të popullsisë në vitin 2001, kur dimensionin etnik hijëzon dimensionin politik, nuk kontribuohet drejt krijimit të zgjidhjeve për problemet reale me domethënie lokale, por drejt fshehjes së tyre pas murit të bërë nga “ne” dhe “ata”. Mobilizimi etnik gjithnjë do të kontribuojë drejt thellësimit të zbrazëtirës në shoqëri.

Kjo gjendje ndikoi në të gjitha sferat e shoqërisë dhe përfshinte njerëz të rinj dhe të mitur. Nxënësit nga shkolla e mesme “Mirko Milevski/ Drita” në Kërçovë kishin konflikt të ndërsjellë me 4 shkurt. Prindërit e të dy palëve protestonin në kufi të dhunës, ashtu që policia u detyrua të ndërhyjë. Komuna Kërçovë veç më ka pasur probleme në lidhje me çështjet etnike. Ndarjet dhe tenzionet vazhduan të rriten edhe gjatë procesit zgjedhor dhe pas tij, deri në ditën e sotme. Civil dhe organizatat partnere publikuan apel për paqe etnike në komunë në numër të madh të rasteve, duke përfshirë edhe incidentin e lartpërmendur në shkollën e mesme.

Ramush Haradinaj u shpall qytetar nderi i Tetovës, gjë që shkaktoi protesta nga ana e maqedonasve etnikë në qytet dhe në vend në fillim të shkurtit. Dinjiteti, parti e ish-personelit ushtarak dhe policor i cili luftoi në konfliktin e vitit 2001 në Maqedoni, partner koalicioni i LSDM-së opozitare, protestoi në Tetovë dhe Shkup. Në fund, vendimi nuk u

zbatua, kurse Ramush Haradinaj nuk udhëtoi në Tetovë.

Çështjet etnike dhe retorika nacionaliste u shfrytëzuan gjithëkund. Kandidati i pavarur për komunën Çashka, pretendohet se, në një tubim më të vogël ka deklaruar: “Do t’i blej votat nga Jabollçishta e Epërme dhe e Poshtme (e banuar me shqiptarë etnik), por nëse bëhem kryetar komune, këto fshatra nuk do të ekzistojnë për mua në të ardhmen”. Kryeministri Gruevski, i shoqëruar nga deputetë dhe zyrtarë tjerë qeveritarë, si dhe përfaqësues nga opozita, kishte dy fjalime nacionaliste në Strugë me 13 mars dhe në Kërçovë me 14 mars. Mediat proqeveritare këto fjalime i quajtën “historike”. Partia qeverisëse solli numër të madh të njerëzve me autobusë nga i gjithë vendi për ta rritur praninë në këto qytete.

Kryeministri Gruevski në Strugë tha: “Nëse ana tjetër mund të sjellë njerëz me aeroplan, autobusë dhe me trena për të votuar, nëse ata njerëz mund të kalojnë mijëra kilometra, edhe ju mund të dilni nga shtëpitë dhe të votoni për Kočovskin dhe për listën këshilluese, e cila është përkrahur nga LSDM dhe partitë tjera. Bëjeni atë për ju dhe për fëmijët tuaj. Mund të mos u pëlqejë njëra apo tjetra parti politike, ajo është e drejta juaj. Por, këtu nuk bëhet fjalë për politikë, por bëhet fjalë për histori!”. Kjo retorikë u përsërit në Kërçovë. Kryeministri Gruevski gjithashtu komentoi për Fatmir Deharin: Duhet t’i tregojmë (Deharit) se Struga është Maqedoni, Kërçova është Maqedoni, dhe se do të jetë Maqedoni! (...) Nëse Fatmir Dehari dëshiron të jetojnë në Shqipëri, ja ku e ka Shqipërinë! Le të shkojë aty dhe aty le të jetojë! Kjo është Maqedoni dhe do të ngelet Maqedoni! Struga dhe Kërçova, Kumanova, Tetova dhe Gostivari, të gjitha këto komuna janë Maqedoni dhe do të ngelen Maqedoni! (...) Me fotografitë e tij me kallashnikov, nuk do të frikësojë askend. Nëse donte të na dërgojë kërcënime, prej këtu e porositim se askend nuk e ka frikësuar, as në vitin 2001, as tani, asnjëherë!” Kryeministri Gruevski gjithashtu iu drejtua grave etnike maqedonase të “lindin më shumë fëmijë” për të tejkaluar numrin e shqiptarëve etnik.

Retorika nacionale dhe fotografia në të cilën kandidati për kryetar komune i BDI-së, Dehari, është i veshur me uniformë të UÇK-së i armatosur me kallashnikov (nga viti 2001) ishin të shfrytëzuara në shkurt me qëllim të dukshëm për të përfituar simpatitë e votuesve, mbi bazë nacionaliste dhe ikonografi militante. AK 47 fotografia vazhdoi të mbetet në profilin personal të Deharit në Fejsbuk deri në ditën e përgatitjes së këtij raporti. Zyrtarë të lartë qeveritarë e përdornin çdo mundësi për t’i nxitur ndjenjat nacionaliste mes maqedonasve etnikë dhe t’i shfrytëzojnë në kontekst zgjedhor. Me atë, qeveria kontriboi drejt thellësimit të mëtutjeshëm të ndarjes etnike dhe tensioneve në vend.

Presion mbi bashkësitë më të vogla etnike

Romët ishin nën presion në Kërçovë për të votuar Fatmir Deharin nga BDI, me argument se “myslimanët duhet të votojnë për mysliman”.

Më 17 mars, policia bëri hetim në shtëpinë e një romi për shkak të dyshimeve se i dyshuari i supozuar ka mbledhur letërnjoftime nga votuesit romë për të manipuluar me të njejtat. Ngeli e paqartë se për çfarë lloj të manipulimit bëhet fjalë në rastin e mbajtjes së letërnjoftimeve të njerëzve, përveç nëse të njejtat nuk kanë qenë votues edhe për anën “tjetër”. Policia kishte urdhër gjyqësor për kërkimin. Personi me prejardhje romë haptazi përmbante BDI-në. Në shtëpinë e tij nuk u gjetën letërnjoftime.

Varësisht prej asaj se kush është përgjegjës në institucion të caktuar në nivel lokal apo qendror, institucionet qeveritare, siç janë policia financiare, policia, përmbarduesit gjyqësor, etj., ushtronin presion mbi anëtarët e bashkësive më të vogla etnike që të votojnë për partitë e njerës nga dy bashkësitë më të mëdha. Është e dukshme se votat e anëtarëve të bashkësive më të vogla kishin rëndësi në garën e pasigurt për pushtet lokal, por jo edhe gjithmonë për njerëzit.

LUFTË
E PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHTET

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

DITËT E VOTIMIT

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

Brethi i parë

Monitorimi i ekipeve të Civilit - Qendrës për Liri, regjistruan numër të madh të parregullsisve dhe keqpërdorimeve gjatë ditës së zgjedhjeve, në rrethin e parë, më 24 mars.

Vlerësimi i përgjithshëm i Civilit për këto zgjedhje është se dita e zgjedhjeve kaloi relativisht qetë, por se e njëjta ishte e shënuar me numër të madh të parregullsisve, të cilat kryesisht rrjedhnin nga keqpërdorimi i institucioneve në nivel lokal dhe qendror. Edhe krahas kërkesave nga ana e Civilit deri te institucionet përkatëse për reagime me kohë dhe pa kompromis, ndërmarrja e aktivitetit të tillë edhe sot e kësaj dite mungon.

Nuk kishte raporte për incidente më të mëdha dhe dhunë. Megjithatë, këto zgjedhje lokale edhe një herë nxorën në pah çështje të mëdha dhe serioze në lidhje me sistemin dhe keqpërdorimin e tij nga ana e pjesëmarrësve kryesorë në zgjedhje. Në të vërtetë, pjesa më e madhe e fushatave ishte e zbatuar mjaft kohë më parë dhe nuk u mundësoi votuesve të votojnë lirshëm dhe sipas dëshirës së tyre. Ata, në mënyra të ndryshme, ishin të kushtëzuar të votojnë, me vende pune, karrierë profesionale, madje edhe me siguri personale.

Civil pranoi informata për shkelje masive të heshtjes parazgjedhore. Sjellja e partive politike ishte e palejuar, sepse ato në fushatat e tyre zgjedhore nuk ndalonin aspak në përpjekjen të ushtrojnë presion të fuqishëm mbi elektoratin. Keqpërdorimi i resurseve shtetërore dhe shoqërore ishin gjerësisht të përhapur dhe aq të dukshme sa i vogël ishte numri i atyre të cilët u munduan ta fshehin prej syve të opinionit. Civil gjithnjë theksonte se sjelljet joligjore dhe metodat jodemokratike i tejkaluan të gjitha kufijtë dhe u bënë realitet i jetës së përditshme.

Pavarësisht frikësimeve serioze, votimi në Kërçovë dhe Strugë kaloi relativisht qetë. Megjithatë, mbetet të shihen pasojat afatgjate të retorikës nacionaliste e cila rrodh nga fushata zgjedhore, dhe e cila me siguri do të rezultojë me shpërthime të mëtutjeshme të tensioneve ndëretnike dhe konflikte në vend.

Zyrtarë të lartë shtetëror dhe deputetë ishin të vendosur si vëzhgues partiakë në Kërçovë. Pavarësisht ligjshmërisë së këtyre aktiviteteve, shtrihet pyetja për legjitimitetin e tyre.

Pati informata për grindje dhe përballje në ditën e zgjedhjeve në komunat Shuto Orizare, Mogilla dhe Çair.

Më së shumti incidente kishte në komunën Çair. U vërejtën grindje, mitosje, transportim i votuesve, pengesa dhe kërcënime për gazetarë dhe pengim i votuesve që të votojnë.

Kërcënime direkte për disa vëzhgues të Civilit kishte nga ana e aktivistëve partiakë në disa komuna. Kishte raste kur anëtarë të bordit zgjedhor i penguan vëzhguesit e Civilit në monitorimin e tyre. Raste të tilla u vërejtën në Kërçovë (vendvotimi 0731), Kumanovë (vendvotimi 1070), Gjevgjeli (vendvotimi 0347), Jegunoc, Veles, Kriva Pallankë dhe disa komuna në qytetin e Shkupit.

Fshehtësia e të dhënave personale në shumë raste dhe në mënyra shumë të ndryshme u shkel gjatë heshtjes parazgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve. U vërejt qasje e përzgjedhur në identifikimin e qytetarëve nga ana e policisë në Tetovë, Zelenikovë, Jegunoc, Kërçovë etj. Në numër të madh të komunave, aktivistët partiakë i merrnin njerëzit nga shtëpitë e tyre dhe në mënyrë të organizuar i sillnin deri te vendet e votimit. Në disa raste votuesit kundër vullnetit të tyre ishin të dërguar të votojnë deri te vendet e votimit.

Në disa raste, vëzhguesit tanë detektuan njerëz të cilët u munduan të votojnë për të dytën herë me letërnjoftim të ndryshëm. Kjo vetëm vërteton se në numër të madh të rasteve llampat dhe sprejet nuk punonin si duhet apo aspak nuk përdorshin.

U pranuan informata për mashtrim sipas teknikës të quajtur “treni bullgar” në disa komuna, siç janë Velesi dhe Manastiri.

Bashkësitë pakicë u ankuan për presion dhe shantazh të cilat kanë ndodhur në numër të madh të komunave në gjithë vendin. Gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve, presion të madh kishte, mbi të gjitha mbi popullsinë rome, si dhe mbi numër të madh të bashkësive më të vogla etnike siç janë turqit, sërëbët e tjerë.

Në këtë raport do të cekim edhe disa parregullsi dhe shkelje tjera, të cilat janë vetëm pjesë e vogël e ngjarjeve të shumta, të cilat e treguan dhe e vërtetuan sjelljen jodemokratike dhe të paligjshme në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale.

Shkelje të heshtjes parazgjedhore

Aktivistë partiakë dhe zyrtarë lokalë u vërejtën si agjitojnë në vendet e votimit në Aerodrom, Manastir, Bogdanci, Bërvenicë, Butel, Çair, Çashka, Dojran, Dollnen, Gjevgjeli, Karposh, Kavadar, Kërçovë, Kratovë, Kriva Pallankë, Kumanovë, Negotinë, Prilep, Radovish, Resnjë, Shtip, Strumicë, Sveti Nikole, Tearcë, Tetovë, Veles dhe Vinicë.

Gjithashtu, aktivistë partiakë u lajmëronin njerëzve të caktuar për t’i “përkujtuar” të votojnë dhe për kë të votojnë (informata nga Shtipi, Shkupi (të gjitha komunat), Jegunoci, etj). Numri 17 (VMRO DPMNE) ishte i shënuar dhe i rrethuar në tabelë në klasë e cila ishte vendvotim në Pllasnicë.

Në Radovish, automobilë të cilët zëshëm e lëshonin himnin e VMRO-DPMNE-së, bënin paradë nëpër qytet gjatë ditës. Disa aktivistë e kishin vendosur himnin e VMRO-DPMNE-së si muzikë në telefonët e tyre dhe e lëshonin në afërsi dhe në vetë vendin e votimit.

Aktivistë të VMRO-DPMNE-së ndanin materiale zgjedhore dhe hap-tazi agjitojnë gjatë heshtjes parazgjedhore. Aktivist i VMRO-DPMNE-së në Gjevgjeli, kur është pyetur se a është i njoftuar me ligjet me të cilat ndalohet sjellja e tillë, është përgjigjur: “Mos u brengosni, me siguri do të fitojmë, ashtu që s’ka kush të na marrë në përgjegjësi”. Në Strumicë, dy partitë kryesore e shkelën heshtjen parazgjedhore me ndarjen e sasive të mëdha të materialit propagandues. Shkelje masive të heshtjes parazgjedhore kishte edhe në rrjetet sociale nga ana e aktivistëve nga të gjitha partitë.

Veçanërisht shqetëson keqpërdorimi i fëmijëve të cilët në ditën e zgjedhjeve valonin flamuj etnikë dhe partiakë. Ka informata për keqpërdorim në disa raste ku arsimtarët kanë përdorur rrjetet sociale për të agjituuar tek nxënësit e tyre, që të njejtët të votojnë për partinë qeverisëse apo t’i bindin prindërit e tyre për të njejtën.

Nga Haraçina dhe Sveti Nikole erdhën informata për aktivistë partiakë të cilët kanë hyrë në vendvotimet mbrëmjen para zgjedhjeve.

Lista zgjedhore

Civil regjistroi numër të caktuar të rasteve në disa komuna ku njerëzit ishin të larguar/nuk gjendeshin në listën zgjedhore. Informata për raste të këtilla ka në shumë komuna, duke përfshirë në Dollnen, Debresht, Kumanovë, Tearcë, Kërçovë, Shkup etj. Sipas vëzh-

guesve të Civilit, mangësi në listën zgjedhore kishte edhe në Dollnen, Prilep, Manastir, Kumanovë, Kërçovë, Likovë, Srugë, Ohër, Shtip, Gazi Babë, Qendër, Butel, Stumicë, Dojran, Vasilevë/Konçe, Gjevgjeli, Tearcë, Tetovë, Bërvenicë, Gostivar, Jegunoc, Zhelinë, Kavadar, Kriva Pallankë dhe komuna tjera. Në Gjevgjeli, komisionet zgjedhore i informonin vëzhguesit e Most-it dhe Civilit për probleme me listën zgjedhore, duke mos ditur si të ballafaqohen me këto probleme.

Shumë raste përfshijnë zhvendosjen e votuesve në vende tjera zgjedhore. Në një rast, një çift martesor i regjistruar në adresë të njejtë në Kërçovë, duhej të votojë në dy vende të ndryshme votimi. Ashtu që, së pari ata duheshin të shkojnë deri te zyrat komunale për të kontrolluar se në cilat vende zgjedhore mund të votojnë, e pastaj të shkojnë ta japin votën e tyre në dy vende të ndryshme. Kishte edhe raste të regjistruara ku votuesit pas artitjes në vendin e votimit, kanë marrë informatën se veçmë kanë votuar. E dukshme është që dikush tjetër ka votuar në emrin e tyre.

Si shembull, një vëzhgues i Civilit në Tearcë ka regjistruar se 45 votues nuk janë në listën zgjedhore në 11 vende zgjedhore. Shkelje të ngjashme janë vërejtur në shumicën e raporteve nga vëzhguesit tanë nga i githë vendi në ditën e zgjedhjeve në rrethin e parë. Madje edhe lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi, nuk ka mundur të votojë pasi që emri i tij nuk ka qenë në listën zgjedhore në Tetovë.

Votimi i personave me aftëzi të kufizuara

Në Kratovë (vendi zgjedhor 0993) bordi zgjedhor në komunë ka sjellë kuti votuese të thyer me shpjegim se e njëjta u ka rënë “duke kaluar nëpër rrugicat e ngushta të qytetit”. Në duart e tyre kanë mbajtur zarfa me vota. Votimi në këtë vend zgjedhor është shpallur i rregullt.

Disa nga personat me aftësi të kufizuara nuk e kanë ditur se janë shënuar si persona me hendikep, gjegjësisht dikush tjetër i ka shënuar të tillë. Shumicës prej tyre “ndihma” u është siguruar nën rrethana të dyshimta. Në Gjevgjeli, anëtarët e komisioneve zgjedhore u ankuan se nuk janë mjaftueshëm të trajnuar për ta zbatuar votimin për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, as ata nuk mbanin kuti votuese, ashtu që zarfat me vota u vendosën në zarf më të madh. Kryetari i këshillit zgjedhor zarfin e ka çuar në shtëpi, kurse të nesërmen e ka dorëzuar në komunë. Numër i madh i votuesve kanë informuar se janë të sëmurë para zgjedhjeve, që të mund të votojnë në shtëpi. Numri i madh i personave të sëmurë shkaktuan dyshime për vlefshmërinë e këtyre votave.

Votimi publik

Janë regjistruar edhe raste që qytetarët të votojnë publikisht, me atë që fletat e hapura të votimit ua kanë treguar vëzhguesve partiakë. Raste të tilla janë vërejtur në Pllasnicë, Çair, Radovish, Bogdanci, Bërvenicë, Aerodrom, Strumicë, Jegunoc, Kavadar. Votimet publike, kryesisht, bëheshin për partitë qeverisëse.

Shkeljet e fshehtësisë së votimit

Leximi me zë i emrave të votuesve është vërejtur në Kratovë, Karposh, Aerodrom. Në rastin në Kratovë, vëzhguesi partiak nga VMRO-DPMNE theksoi se i është thënë se leximi i emrave të votuesve duhet të bëhet me zë, si rregull.

Votimi familjar/votim përmes përfaqësuesit

Votim familjar/votim përmes përfaqësuesit është vërejtur në komunat Dollnen, Manastir, Pllasnicë, Kumanovë, Shtip, Shuto Orizare, Saraj, Jegunoc, Strumicë, Radovish, Bogdanci, Tearcë, Haraçinë, Mavrovë, Rostush, Kavadar, Veles, Tetovë, Strugë, Çair dhe të tjera. Në numër të caktuar të vendeve zgjedhore, këshillet nuk reagojnë për këtë mënyrë të votimit.

Evidentimi i votuesve

Aktivistë të VMRO-DPMNE-së, por gjithashtu edhe vëzhgues të partive tjera (edhe nga opozita edhe nga kolacioni qeverisës) vëreshin në afërsi të vendeve të votimit, ku mbanin evidencë të personave të cilët kanë votuar, që është gjithashtu formë e presionit dhe kontrolli i palejuar mbi elektoratin.

Aktivistë partiak para vendeve, në koordinim me vëzhguesit partiakë

në vendet e votimit, kanë mbajtur evidencë të votuesve, duke i rrethuar emrat e tyre në lista paraprakisht të përgatitura apo me shënimin e emrave të tyre. Në një rast, është vërejtur koordinim mes vëzhguesve nga OJQ dhe atyre të cilët kanë mbajtur evidencë nga VMRO-DPMNE.

Mbajtja e evidencës është vërejtur në Resnjë, Sveti Nikole, Kërçovë, Çair, Karposh, Aerodrom, Strumicë, Radovish, Bogdanci, Tearcë, Zhelinë, Çashka, Veles, Kriva Pallankë, Kavadar, Prilep.

Kjo paraqet formë specifike të presionit ndaj votuesve, si pjesë e aktivitetit të organizuar për të ndikuar mbi votuesit.

Rrethi i dytë

Rrrethi i dytë i zgjedhjeve lokale (7 prill) ishte – përsëri - i shoqëruar me shumë parregullsi, incidente, tensione dhe presione. Edhe pse nuk janë regjistruar incidente më të mëdha dhe dhunë fizike dhe e armatosur, rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale përsëri tregoi se ende janë të hapura çështje serioze të sistemit si tërësi dhe keqpërdorimi i tij nga ana e lojtarëve kryesorë në procesin zgjedhor.

Në rrethin e dytë haptazi zhvillohej ndërhyrje serioze demografike në Kërçovë për qëllime etnike dhe partiake. Varfëria e popullit keqpërdorej në masë të madhe dhe në mënyra të ndryshme vetëm për të fituar pushtetin.

Rrethi i dytë i zgjedhjeve filloi me atmosferën veçanërisht të tensionuar në Kërçovë ku ishte e dukshme prania policore, sidomos pas arrestimeve një ditë më parë. Kishte pohime se personat e burgosur ishin anëtarë të LSDM-së opozitare. Në shumë raste në këtë komunë u vërejt blerje e votave. Përveç kësaj, në lagje rome janë vërejtur raste të shumta të votimit familjar. U regjistrua se persona të cilët gjoja ishin analfabetë kërkuan ndihmë kurse më vonë u ndihmonin të tjerëve, të cilët gjithashtu pohonin se janë analfabetë.

Në Veles, njëri nga vëzhguesit e Civilit, i cili ishte i akredituar nga KSHZ-ja dhe kishte dokument të vlefshëm nga Civili, u pengua të hyjë në vendin e votimit numër 2147.

Vëzhguesit e OJQ “Platformë kundër varfërisë” ishin të larguar nga vendet e votimit nga ana e policisë, kurse më vonë iu lejua qasje pa shpjegim. Në vendin zgjedhor numër 2164 është vërejtur përpjekje për fotografim. Janë vërejtur aktivistë partiakë të VMRO-DPMNE-së të cilët agjitojnë para vendeve të votimit. Në vendin e votimit numër 2172 aktivistë partiak të cilët mbanin lista me votues i evidentonin votuesit. Para vendeve të votimit grupoheshin njerëz nga agjensioni për sigurim personal në pronë të anëtarit të partisë qeverisëse. I njëjti agjension or-

ganizonte dhe transportonte votues deri te vendet votuese. Në fshatrat Ivankovci dhe Orizar e Poshtme dhe e Epërme aktivistët partiakë dhe të punësuar në administratë u kanoseshin një pjesë të qytetarëve me revokimin e subvencioneve.

Në Shkup dhe në disa komuna tjetër në vend pati mbi dhjetë raste të pengimit të punës së vëzhguesve të Civilit. Ata të cilët i pengonin ishin kryesisht nga këshillat zgjedhorë në vendet zgjedhore.

Në vendin e votimit numër 2556 në Gjorçe Petrov u vërejt përpjekje për fotografimin e fletëvotimit.

Në komunat Gjorçe Petrov, Aerodrom dhe Karposh në Shkup dhe në Tetovë të gjitha partitë shkelën heshtjen zgjedhore me ndarjen e fletushkave.

Në Strumicë ekipet tona na informuan për prani të madhe të policisë dhe atmosferë të tendosur. Një kuti votimi ishte thyer dhe pati të shtëna nga pushkë ajrore në Strumicë.

Në Karposh dhe Veles në listën zgjedhore për votues fuguronin edhe njerëz të vdekur.

Në komunën Qendër (lagjja Kapishtec) emrat e votuesve lexoheshin me zë.

Në komunën Çair aktivistë partiakë në vendet e votimi kishin lista të votuesve dhe i evidentonin ata. Pati edhe raste të votimit publik (vendvotimi numër 2945). U vërejt transport i organizuar i votuesve. U evidentuan edhe disa raste të votimit në emër të dikujt tjetër, si dhe përpjekje për votim me letërnjoftim të huaj. Raste të tilla pati edhe në fshatin Çajle në komunën Gostivar.

Morëm informata nga Tetova se aktivistët partiakë kanë ofruar para për vota para shkollës fillore “Qirili dhe Metodi”.

Në Resnjë në mëngjes janë parë makina nga Shqipëria. Pretendohet se kanë transportuar votues nga Pusteci.

Pasdite u vërejtën numër më i madh i parregullsive në shumë vendvotime në vend.

Civil pranoi ankesa nga qytetarë nga një fshat në Berovë të cilët deklaruan se aktivistë partiakë të VMRO-DPMNE-së u janë kanosur se do t’i vrasin dhe do t’ua djegin pronën në qoftë se nuk votojnë për parti-në e tyre.

Votime në emët të tjetërkujt janë vërejtur në Manastir, Nagoriçane e Vjetër, Gostivar, Çair, Tetovë, Tearcë, Strugë, Jegunoc dhe vende tjera.

Pusteci në Shkup

Në ditën e rivotimit atmosfera në komunën Qendër ishte mjaftë tensionuese. Sipas raporteve, votues nga Pusteci janë sjellë në disa vende të votimit në komunë dhe kanë shkaktuar revoltë te qytetarët. Civil pranoi shumë thirrje telefonike dhe kuptoi për lëvizjet e votuesve të “importuar”.

Në orët e vona të pasditës para mbylljes së vendeve të votimit u krijuan tension në komunën Qendër. Sipas raporteve të vëzhguesve dhe telefonatave të shumta nga qytetarët, qytetarë nga Pusteci pushtuan disa vende votimi nga të cilat janë ndarë: Shtëpia e ndërtimtarëve, Federata e futbollit të Maqedonisë, lagjla Kapishtec dhe shkolla 11 Tetori. Edhe mediat e pavaruara kanë vërejtur votimin masiv.

Përveç qytetarëve të cilët kanë ardhur nga Pusteci, vëzhgues tjetër i yni, si dhe qytetarë i kanë vërejtur “qytetarët e rinj” të Qendrës, të cilët kanë ardhur nga komuna Kavadar, dhe me siguri nga komuna tjera maqedonase.

Sipas dëshmitarëve, kishte prani të madhe policore për t’i mbrojtur qytetarët e “importuar”.

Listë e gjatë e parregullsive

Votim familjar dhe grupor, agjitim politik dhe shkelje të heshtjes zgjedhore; transport i organizuar; mitosje e qytetarëve; kërcënime; materiale votuese të paplota; numër i zmadhuar i personave kinse analfabetë; persona me aftëzi të kufizuar dhe të sëmurë; anëtarë të këshillave zgjedhorë pa dokumente identifikimi; prani e madhe e policisë; prani e funksionarëve të lartë shtetërorë.

Në disa vendvotime janë vërejtur presione dhe pengesa në punë edhe për vëzhguesit e Civilit dhe të organizatave tjera.

Intervale të tensionuara

Ditët mes rretheve zgjedhore të votimit ishin të njejta si para vetë fillimit të procesit zgjedhor. Vëzhguesit tanë raportnin për fushata të ndyera në terren, fushatë agresive mediale, aktivitete të shpeshtuara derë në derë, punësime zgjedhore, kërcënime, keqpërdorim i adminis-

tratës dhe resurseve publike etj. Tensionet etnike ishin vazhdimisht të larta.

Qytetarët i përjetonin shumicën e aktiviteteve të tilla të partive politike si presion. Ata shpesh i lajmëronin grupet tona punuese apo zyrën tonë në Shkup për të paraqitur parregullsitë e shumta. Civil apelonte për zgjedhje të lira në më shumë raste dhe e vazhdoi fushatën e vet për ngritje të vetëdijes publike.

Rivotimi më 21 prill

Parregullsi, presione, tensione, manipulime, ndërhyrje demografike dhe lloje tjera të dhunës strukturore janë karakteristikë e këtij cikli zgjedhor në përgjithësi, kurse përjashtim nuk ishte as rivotimi me 21 prill, sidomos gjatë rivotimit në komunën Qendër.

Rivotimi në rrethin e dytë të zgjedhjeve me 21 prill e rrumbullaksuan Rimazhin e zgjedhjeve lokale 2013 në Maqedoni. Ajo ishte pikturë e luftës të paskrupullt për pushtet në të cilën shkelej mbi dinjitetin e qytetarëve. Dhe, përsëri dhuna strukturore dhe padrejtësia shoqërore lanë shenjë të fortë si mjete të paturpshme për fitimin e pushtetit. Më të shfrytëzuar, të shantazhuar dhe të manipuluar ishin të sëmurët, invalidët, të papunësuarit, fëmijët dhe të rinjtë, shfrytëzuesit e ndihmës sociale dhe të varfërit. Ata e bartën barrën e veprimeve jodemokratike të qendrave të fuqisë. Shembull më shokues për këtë është manipulimi me qytetarët/qytetaret e Pustecit të Shqipërisë. Duke marrë pjesë në parregullsinë më të madhe të procesit zgjedhor, ata ishin të shfrytëzuar dhe të ekzozuar ndaj çdo lloji poshtërimi dhe stigmatizimi publik. Të punësuarit në administratën publike ishin të shantazhuar dhe të shfrytëzuar për qëllime partiake.

Edhe një herë, përsëritja e votimit në Qendër nxori në pah mangësi serioze institucionale, të cilat rezultuan me shkelje të rendit juridik.

Numër më i madh i parregullsive dhe tensioneve u vërejtën gjatë rivotimit në komunën Qendër në Shkup. Parregullsi dhe presione u regjistruan edhe gjatë rivotimit në komunën e Strugës dhe votimit në rrethin e dytë në komunën Dollnen.

Rivotimi kaloi në atmosferë të tensionuar, gjegjësisht me shfrytëzim maksimal të institucionve për kryerjen e presionit mbi votuesit. Ishte e dukshme prania e zmadhuar e policisë në të gjitha komunat ku atë ditë votohej. U vërejtën më shumë makina pa targa në afërsi të vendeve të votimit.

Civil konstaton se gjatë votimit në Qendër, edhe një herë u përdor ndërhyrja demografike. Qytetarëve të ardhur për votim nga Pusteci, këtë

herë iu bashkangjiten dhe i përforcuan “votues të rinj” nga Velesi, Strumica, Kavadari, si dhe nga komunat e Shkupit, Aerodrom dhe Butel. Nga burim anonim kuptuam se mes “votuesve të importuar” ka pasur edhe të tillë nga Gora e Kosovës, të cilët gjoja kanë ardhur të votojnë në Qendër në mënyrë të organizuar, njejtë sikur votuesit e Pustecit.

Të regjistruar janë edhe votues të cilëve në dokumentet personale nuk u është shënuar vendi i lindjes. Në vend të kësaj u është shënuar “XXX”. Në komunën Qendër u vërejtën një seri përpjekjesh “inventive” për dezinformimin të qytetarëve me qëllim që të mos dalin në votim. Ishin lënë numër i madh i fliaerëve në të cilat pohohet se rivotimi është me 28 prill me nënshkrim të falsifikuar të kandidatit për kryetar të komunës Zhernoski. Gjatë votimit, e njejtë ndodhte edhe para disa vendeve të votimit, ku aktivistët partiakë të VMRO-DPMNE-së i bindnin njerëzit se nuk votohet atë ditë apo se aty nuk është vendi i tyre i votimit, me qëllim që të futet hutim dhe të zvogëlohet pjesëmarrja.

Ashensorët e disa ndërtesave në rrugët “Fronti popullor” dhe “Vasill Gjorgov” u vunë jashtë përdorimit në mënyrë “misterioze”.

Obstruimi i gazetarëve dhe vëzhguesve

Para Shtëpisë së ndërtimtarëve, anëtarë të policisë me veshje civile i legjitimonin dhe i evidentotnin gazetarët e pranishëm, ndërkohë që refuzonin të prezentohen para tyre.

Aktivistë partiakë të VMRO-DPMNE-së i pengonin ekipet televizive dhe gazetarët ta kryejnë detyrën e tyre në disa vende zgjedhore të komunës. Një gazetarë të Nova TV-së ka qenë e maltretuar dhe e goditur nga anëtar i komisionit zgjedhor në Shtëpinë e ndërtimtarëve.

Puna e vëzhguesve të Civil-it ishte e penguar nga ana e komisioneve zgjedhore në disa vende të votimit.

LUFTË
E PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHTET

PERIUDHA PAS ZGJEDHJEVE

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

Keqësimet vazhdojnë

Natën pas rrethit të dytë të zgjedhjeve në komunën Qendër, administrata e kryetartë të mëparshëm të komunës Vlladmir Todoroviq vendosi mbi 30 përmendore. Në radius prej vetëm disa qindra metrave u zbatuar operacion i madh teknik në përpjekje të dukshme të tregohet fuqi dhe dominim.

Prerja e drurëve të vjetër dhe hapja e investimeve të reja në komunën Qendër vazhdon edhe krahas protestave publike dhe vënies së projektit në pritje nga ana e kryetarit të ri të komunës Andrej Zhernoski, i cili paralajmëroi kontroll financiar të projektit të diskutueshëm Shkupi 2014. Në ditët dhe javët pas zgjedhjeve, administrata e re në komunë u përball dhe ende ndeshet me presion të paparë nga partia qeverisëse e cila atë e bënë në mënyra të shumta. Presioni i tillë përfshin obstrukcione të shumta administrative, si dhe protesta të dhunshme në të cilat sulmohen edhe zyrtarët komunal në “mbrojtje” të kishës, e cila është pjesë e Shkupit 2014.

Disa anëtarë të sapozgjedhur të këshillave komunalë ndërruan anën, gjegjësisht edhe pse ishin të zgjedhur si kandidatë të opozitës, ata i'u bashkangjiten partisë qeverisëse (në Veles, Qendër, Kumanovë, etj.).

Nga të gjitha anët e vendit arritën informata për punëtorë të pushuar nga puna. Pas informatave të tilla pasuan mohime, si dhe shpjegime se punëtorët e pushuar kanë qenë pjesë e “punësimeve zgjedhore” për blerjen e votave.

Menjëherë pas mbarimit të zgjedhjeve filluan edhe grindjet e brendshme për atë se kush më së shumti meriton të punësohet.

Në Kërçovë për herë të parë u ngrit flamuri shqiptar para ndërtesës së komunës. Nga ana e shqiptarëve vijonin shpjegime dhe miratime, kurse në anën maqedonase u krijua zemërim dhe shqetësim.

Edhe pas mbarimit të zgjedhjeve në vend vazhdoi diskreditimi i kundër-

shtarëve politikë përmes mediave dhe shfaqjeve publike të liderëve politikë. Nuk u organizuan debate publike për gjetjet e misioneve vëzhguese, as nuk u ndërморën hapa në lidhje me rekomandimet e ODIHR-së dhe institucioneve dhe organizatave tjera përkatëse me qëllim që të përmirësohen rregullat dhe praktikat zgjedhore.

Partia kryesore opozitare kaloi në proces të ndërrimit të liderit të kahmotshëm Branko Cërvenkovski me Zoran Zaevin, i cili fitoi mandat të tretë për kryetar të komunës Strumicë.

Funksionari “i rebeluar” opozitar Stefço Jakimovski, kryetari i ri-i vjetër i Karposhit, formoi partinë e tij të quajtur Grom, përderisa edhe një ish-funksionar i LSDM-së Vllado Buçkovski dhe disa të tjerë janë në proces të formimit të partisë së re politike. Disa parti më të vogla politike u shkëputën nga blloku opozitar dhe i’u bashkangjitën koalicionit qeverisës apo veprojnë vetë në skenën e fragmentuar politike në vend.

Ndërkohë, gjendja e demokracisë, të drejtat dhe liritë e njeriut, veçanërisht liria e shprehjes në vend po keqësohen.

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

Gazetari nuk do të krijojë as nuk do të përpunojë me vetëdije informacione të cilat i rrezikojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim mbi asnjë bazë (diskriminim nacional, fetar, racor, gjinor, social, gjuhësor, të orientimit seksual, politik...)

Informimi për proceset politike, veçanërisht për zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar.

Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale nga subjektet politike.

(Kodi i gazetarëve të Maqedonisë neni 10 dhe neni 14)

ROLI TURPSSHËM I MEDIAVE

Është mrekulli e vërtetë që në Zgjedhjet lokale 2013 nuk pati përballje dhe dhunë fizike. Kjo për fat të keq është vlerësimi i vetëm inkurajues dhe mezi i kalueshëm në zgjedhjet. Zgjedhjet nuk ishin as korrekte, as të lira, aq më pak demokratike. Fushata ishte më e dhunshmeja, ndërsa zgjedhjet më të ndyra deri më tani.

Në kushte të këtitilla vetëm për partinë në pushtet (VMRO DPMNE) zgjedhjet ishin “festë e demokracisë”. Vëzhguesit e huaj dhe vendorë as në shenja nuk i përmendin kategoritë korrekte, të lira, pa dhunë dhe demokratike.

Misioni i OSBE/ODIHR zgjedhjet i cilësoi si të qeta, të zbatuara në mënyrë efikase, konkurrense, por edhe jo të barabartë. Sipas Misionit, shkaku kryesor është “mbulimi medial i njëanshëm dhe partiak dhe përzjerja e aktiviteteve qeveritare dhe partiake”.

I turpshëm ishte roli i shumë mediave, para së gjithash, i atyre elektronike, të cilat drejtpërdrejt kontribuan që në procesin zgjedhor të mungojnë kategoritë të lira dhe jo të dhunshme. Këto media, si asnjëherë më parë, në mënyrë agresive dhe në mënyrë transparente i kanë mbështetur partitë e koalicionit në pushtet, si në regjimet më totalitare njëpartiake. Shkurt, mediat e kanë luajtur rolin e megafonëve partiako-shtetërorë.

Më larg me njëanshmërinë shkuan RTVM, edhe pse është servis publik në interes të të gjithë qytetarëve, por edhe TV Sitel, si dhe gazetat “Veçer” dhe “Dnevnik”.

TV stacionet e tjera ishin të prirura ndaj qeverisë, por në masë më të vogël, me përjashtim të TV Telma, e cila sipas të dhënave të KRD-së, si dhe shqyrtimit të Civilit, më shumë kujdes i kushtoi koalicionit opozitar. Në mesin e mediave të pavarura, i veçojmë magazinën javore politike dhe gazetën ditore Fokus të cilat nuk dolën më pas rrethit të parë të zgjedhjeve, për shkak të vdekjes tragjike dhe akoma të pasqaruar të pronarit të tyre Nikolla Mlladenov.

Në mënyrë të balancuar për zgjedhjet kanë njoftuar TV 24 Vesti, TV Alfa, TV Alsat M dhe Radio Kanal 77, në mesin e mediave elektronike, Utrinski vesnik, Koha dhe Lajm në mesin e mediave të shtypit, si dhe internet portalet mkd-news.com dhe portalb.mk.

Mediat, me mbështetje të hapur, nuk ishin vetëm të njëanshme, por ishin pjesëmarrës dhe aktorë të drejtpërdrejtë në fushatën në anën e

partive të pushtetit. Veç kësaj, pati edhe gjuhë të urrejtjes, ofendime personale dhe nënçmime në llogari të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, veçanërisht të atyre të bllokut opozitar.

Veçanërisht i rrezikshëm dhe joprofesional ishte roli i mediave në format e nacionalizmit në lidhje, para së gjithash, me zgjedhjet në Kërçovë dhe Strugë. Në vend se t’i dënojnë dukuritë e nacionalizmit, të distancohen prej tyre, një pjesë e mediave me retorikë të theksuar nacionaliste, nxisnin urrejtje dhe jotolerancë etnike.

Njëanshmëria e një pjese të mediave ishte e dukshme edhe gjatë zgjedhjeve për kryetarin e komunës së Qendrës. Fitorja në këtë komunë ishte imperativ për partinë në pushtet, para së gjithash, në mbrojtje të projektit Shkupi 2014. Për këtë, midis dy raundeve dhe gjatë rivotimit mediat “partiake” kanë udhëhequr fushatë të vërtetë kundër kandidatit të opozitës, i cili publikisht u degradua dhe u akuzua për korrupsion.

Këto vlerësime hyrëse bazohen në media monitorimin e vëllimshëm të Civilit, ekipet e të cilit në kuadër të projektit Zgjedhje të lira dhe pa dhunë çdo ditë i kanë ndjekur gazetaret ditore Fokus, Dnevnik, Nova Makedonija, Utrinski Vesnik, Veçer, Koha dhe Lajm dhe javoret Fokus dhe Republika. Në kuadër të monitorimit janë ndjekur edhe mediat elektronike më me ndikim dhe internet portalet më të lexuara. Në raport janë përdorur edhe të dhënat e Këshillit të Radiodifuzionit (KRD).

Civil, në kuadër të fushatës për rritjen e vetëdijes publike, me apele, kumtesa dhe klipe insistonte të kontribuojë për zgjedhje të lira dhe pa dhunë. Apelet e vazhdueshme, pothuajse të përditshme, për fat të keq nuk kanë prekur deri te shumica e mediave, për shkak të njëanshmërisë së tyre dhe animeve ndaj partive në pushtet. Mediat proqeveritare në mënyrë selektive dhe të pamjaftueshme kanë lënë hapësirë për apelet dhe raportet e Civilit. Servisi publik i mbylli dyert për fushatën për rritjen e vetëdijes publike, kundrejt kërkesës së rregullt të Civilit. Ata, thjesht, u bënë të shurdhër për kërkesën tonë për t’i emetuar klipet e Civilit, pavarësisht faktit që bëhej fjalë për fushatë me interes të qartë shoqëror. Mirëkuptim dhe mbështetje për aktivitetet e Civilit pati në televizionet Telma, 24 Vesti, Alfa TV, TV Era, Alsat-M, portalet Plus Info, Nova TV, Brif, Portalb, Libertas, Dardania, gazeta dhe javorja Fokus për çka edhe në këtë rast Civil u shpreh falënderim.

MEDIA TË KONTROLLUARA

Roli i turpshëm i mediave në fushatën dhe zgjedhjet, njëanshmëria me të cilën u ndalën pas partive të pushtetit, vetëm i konfirmuan vlerësimet për pozitën dëshpëruese dhe katastrofike në të cilën, viteve të fundit, gjithnjë e më thellë mbytet gazetaria në Maqedoni. Në vepër u konfirmua se koalicioni i partive në pushtet e mban nën kontroll të fuqishëm pothuajse të gjithë hapësirën mediale në Maqedoni. Si në kohët e regjimeve totalitare njëpartiake.

Një pjesë e mirë e mediave dhe gazetarëve, në një garë pa mend dhe të turpshme, se kush do të jetë më pranë pushtetarëve, në mënyrë brutale i kanë shkelur normat profesionale, kanë shkelur kode, ligje... Njëanshmëria me të cilën mediat dhe gazetarët ishin pjesëmarrës aktivë në fushatën zgjedhore do të mbetet përgjithmonë njollë e zezë në historinë e gazetarisë së Maqedonisë.

Liria e medias si e drejtë e pamohueshme, e garantuar me Kushtetutën, definitivisht u varros në këto zgjedhje. Bashkë me gazetarinë dhe mediat janë varrosur liritë dhe të drejtat e njeriut, të të menduarit, shprehurit, informimit, janë varrosur demokracia dhe shoqëria civile. Liritë u kthyen në joliri.

Kriza e gazetarisë dhe agonia e medias, nuk janë që sot. Gjendjet viteve të fundit vazhdimisht, në mënyrë sistematike po përkeqësohen. Për këtë gjë pritej se një pjesë e mediave do të jenë të njëanshme, por se do të ulen deri në nivelin më të ulët të mundshëm, deri në nivelin e agitatorëve partiakë, vështirë se mundej edhe të supozohej. Janë tejkaluar parashikimet më negative.

Shkaqet për të cilat mediat janë sjellë në gjendje jo të lirë, për të cilat vazhdojnë vetë më thellë të rrënohen në nënshtrime dhe varësi janë të ndryshme dhe shumëstresore. Pjesa më e madhe e shkaqeve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë lidhen me përcaktimin e pushtetit që mbarë hapësirën mediale ta rregullojë sipas nevojave të veta dhe politikave të ngushta partiake.

Kjo është strategji e menduar dhe e planifikuar mirë të cilën VMRO-DPMNE, nga ardhja në pushtet në vitin 2006, bashkë me partnerët e koalicionit, në vazhdimësi dhe në mënyrë konsekuente e kanë zbatuar, bile kur është dashur edhe me përdorimin e forcës. Pushteti me një strategji të këtyre siguroi pothuajse varësi të plotë, ndërsa mediat dhe gazetarët i çoi drejt varësisë totale vazale. Strategjia me të cilën është realizuar kontrolli në tërë hapësirën mediale është e njohur. Shkurtime isht do t'i nënvizojmë drejtimet kryesore.

Vetëreklamimi. VMRO-DPMNE në shtatë vitet e kaluara, prej se është në pushtet, është në fushatë të vazhdueshme mediale për vetëreklamim, si të partisë ashtu edhe të Qeverisë. Me paratë e buxhetit, Qeveria dhe partia u shndërruan në reklamuesin më me ndikim medial, ndërsa me shumat, të cilat janë fshehtësi, blihet “dëgjueshmëria” e mediave.

Strategjia e këtyre siguron dobi të dyfishtë. Qeveria dhe partia vazhdimisht janë të pranishme në hapësirën mediale, vetëreklamohen, e fryjnë rejtingun, ndërsa njëherësh i mbajnë nën kontroll mediat. Imponojnë bindje dhe vetëcensurë, pasi që për shkak të shkrimeve kritike mediat mund të mbeten pa reklama dhe pa para.

Mungesa e tregjeve. Pas pavarësisë së Maqedonisë filluan të formohen kushtet tregtare për mediat, por mbetën vetëm në fillimet. Ajo pak që është krijuar është fshirë me intervenimet e pushtetit i cili një pjesë të parave i ndante në disa media të caktuara duke i vënë në pozitë monopoliste. Mbi këto baza u lidh dhe u ndërtua strategjia e vetëreklamimit e cila deri në fund e rrënoi tregun. Mediat të cilat nuk ishin dhe nuk deshën të jenë nën kontrollin e pushtetit, i humbisnin pozitën në treg, disa shiteshin, disa thjesht shuheshin.

Struktura e pronësisë. Struktura e pronësisë mbi mediat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon mbi (pa)varësinë e tyre. Pati faza të ndryshme. Në fillim themelues dhe pronarë të mediave ishin gazetarët. Tani mediat kryesisht janë në duart e biznesmenëve të cilët janë afër pushtetit. Disa për shkak të interesave politike (anëtarë të koalicionit qeveritar), shumica për shkak të biznes interesave. Me tërheqjen e kompanisë gjermane WAC nga Maqedonia dhe me shitjen e TV Alfa, pothuajse është përmblyllur struktura pronësore e afërt me pushtetin. Mbetën mezi disa oaza jashtë këtyre grupacioneve.

Përdorimi i forcës. Duke e zbatuar strategjinë për kontrollin mbi mediat pushteti kur duhet përdor edhe forcë. Shembulli më drastik është mbyllja e TV A1 dhe tri gazetave ditore. Kjo ishte vërejtje e qartë për të gjithë pronarët e mediave. Ushtrim më vete i forcës janë edhe paditë për shpifje kundër mediave dhe gazetarëve të cilët në mënyrë kritike shkruajnë për pushtetin. Frikësim është edhe “thirrja” e emërtuar e përkohshme e “gazetarëve të papërshtatshëm” nga ana e pushtetit. Frikësim dhe zbatim i forcës ishte edhe përjashtimi i gazetarëve nga galeria e Kuvendit...

Përçarjet. Pjesë përbërëse e strategjisë për kontrollin e hapësirës mediale është përçarja midis gazetarëve. Megjithatë, nëse jo me nismën e qeverisë, atëherë me mbështetjen e saj, gazetarët ndahen në “patriotë” dhe “tradhtarë”. Më pas të drejtë ekskluzive për të qenë “patriotë” kanë vetëm gazetarët të cilët verbërisht dhe si shërbëtorë e mbështesin dhe

e madhërojnë pushtetin. Të gjithë të tjerët “janë tradhtarë” Ndarja e imponuar shtesë e devalvoi gazetarinë si profesion, ndërsa pushteti me ndihmën e “patritoëve” të saj fut norma të reja dhe kritere në hapësirën mediale.

Ka edhe një sërë çështjesh të tjera, por edhe këto janë më shumë se të mjaftueshme Maqedonia vazhdimisht të mbytet në rang listat e lirisë së mediave në botë. Për vetëm katër vjet në rang listën e Reporterëve pa Kufij ra për 82 pozita dhe ndodhet në pozitën e 116. Kjo më shumë se mjaftueshëm flet se në çfarë jolirie brengosëse ndodhen dhe punojnë mediat dhe gazetarët në Maqedoni.

Brengosje serioze për shkak gjendjes me lirinë e mediave në Maqedoni shprehën edhe Departamenti Amerikan I Shtetit, në raportin vjetor, si dhe Bashkimi Evropian (BE). As këto sugjerime, as mbytja në fund të rang listave të lirive të mediave nuk ishin nxitje që të ndryshojnë gjërat. Nuk ka as shenja se gjendjet do të përmirësohen. Përkundrazi, me Ligjin e ri për mediat, i cili me fuqi po u imponohet gazetarëve, ndërsa i cili sipas shumë vlerësimeve vendos censurë të hapur, Maqedonisë i kano-set që jolirinë ta zëvendësojë errësira e plotë mediale.

Gjendjet e theksuara ndoshta e shpjegojnë, të paktën pjesërisht, sjelljen e gazetarëve dhe mediave gjatë zgjedhjeve, por as në asnjë rast nuk mund t'i arsyetojnë.

Mediat elektornike

Maqedonia krahasuar me madhësinë dhe numrin e banorëve ka një numër të madh mediash elektronike. Sipas Këshillit të Radiodifuzionit (KRD) në mënyrë legale funksionojnë 187 televizione dhe radio. Megjithatë, cilësia e programit të tyre është në rënie, ndërsa në pjesën informative është kontestues objektiviteti i informimit i shumicës së mediave elektronike. Kjo kryesisht është pasojë e përzierjes së pushtetit dhe politikës në sferën e mediave, strukturën e pronësisë, si dhe interesat politike dhe të biznesit, për të cilat pronarët lidhen me institucionet e shtetit.

Këto dobësi të njohura në mediat elektronike erdhën në shprehje të plotë gjatë Zgjedhjeve lokale, në të cilat, në vend të qasjes së barabartë dhe prezentimit korrekt të të gjithë pjesëmarrësve kryesisht pati “tifo” për partitë në pushtet. Në disa media raporti ishte madje 3 me 1 në favor të partive në pushtet. Mediat të cilat njoftuan në mënyrë të balancuar, ishin përjashtim.

Sipas monitorimit të KRD-së në shumicën e mediave përfaqësim më të madh kanë pasur koalicioni “Për Maqedoni më të mirë”, i kryesuar nga VMRO-DPMNE, si dhe BDI, përballë Koalicionit opozitar “Aleanca për ardhmërinë”, i kryesuar nga LSDM-ja, si dhe PDSH-së. Disbalanci mund të shpjegohet vetëm pjesërisht me intensitetin e ndryshëm të aktiviteteve të partive.

Disbalanc, njëanshmëri më e madhe sipas KRD-së është regjistruar te: TVM1, më pas Radioja e Maqedonisë – Programi i parë, si dhe te TV Sitel. Disbalanc ka edhe te mediat e tjera, por në vëllim më të vogël.

Në mënyrë të balancuar ka njoftuar vetëm TV Alsat M, ku kryesisht në mënyrë të barabartë janë prezentuar partitë e pushtetit dhe opozitës, si të kampusit shqiptar ashtu edhe atij maqedonas. Kryesisht njoftim të barabartë dhe të balancuar patën edhe 24 Vesti dhe Alfa, si dhe Radioja Kanal 77.

Vështrimi i mëvetësishëm, i bërë në bazë të të dhënave të Raportit të KRD-së për monitorimin e zgjedhjeve lokale e tregon, jo vetëm disbalancin dhe njëanshmërinë e disa mediave, por edhe i ilustron edhe gjendjet e përgjithshme në hapësirën mediale.

Televizioni i Maqedonisë – programi i parë

Servisi publik i Televizionit të Maqedonisë, në programin e parë, fushatës së Zgjedhjeve lokale 2013 i ka kushtuar 16 orë të tëra. Në këtë numër është përfshirë edhe koha kushtuar “aktiviteteve të rregullta” të Qeverisë dhe ministrive, të cilat ishin drejtpërdrejt në funksion të zgjedhjeve. Më pas bie në sy se RTVM 1 aktivitetet e rregullta të Qeverisë u ka kushtuar më shumë kohë sesa koalicionit opozitar.

Koalicioni i kryesuar nga VMRO-DPMNE në dy TV ditarët e RTVM1 është prezentuar me 5 orë e 25 minuta. Koalicioni i kryesuar nga LSDM-ja është prezentuar me 2 orë e 44. Raporti midis përfaqësimit të partive të pushtetit dhe opozitës është pothuajse 2 ndaj 1.

Por ky raport nuk është real pasi që “aktivitetet e rregullta” të Qeverisë dhe ministrive janë përfaqësuar me 3 orë e 26 minuta.

Kësaj duhet t’i shtohet se emisioneve të veçanta të analizave të ekspertëve lidhur me Zgjedhjet lokale u është kushtuar 1 orë e 15 minuta. Kur grumbullohen, aktivitetet e koalicionit qeveritar, të Qeverisë dhe analizave të ekspertëve u është kushtuar rreth 9 orë, ndërsa koalicioni opozitar është përfaqësuar me më pak se 3 orë.

Është relativisht i vogël përfaqësimi i subjekteve të tjera politike. Aktivitetet e BDI-së, partner i koalicionit në pushtet janë shoqëruar vetëm me 29 minuta, ndërsa PDSH-ja opozitare është prezentuar me 19 minuta.

Televizioni i Maqedonisë – programi i dytë

Servisi publik i Televizionit të Maqedonisë, në programin e dytë në dy TV ditarët në gjuhën shqipe zgjedhjeve lokale u ka kushtuar 15 orë e 53 minuta, me ç’rast nuk ka disbalanc drastik si në programin e parë.

Më së shumti kohë 2 orë e 51 minutë u janë kushtuar aktivitetet të BDI-së. PDSH-ja opozitare është përfaqësuar me 2 orë e 2 minuta.

Me kohë identike prej 2 orë e 2 minuta është përfaqësuar Koalicioni i kryesuar nga LSDM-ja, ndërsa për Koalicionin e kryesuar nga VMRO-DPMNE-ja janë ndarë 1 orë e 54 minuta. Megjithatë, “aktivitetet e rregullta” të Qeverisë dhe ministrive janë shoqëruar me 1 orë e 22 minuta.

Radioja e Maqedonisë – servisi i parë programor

Programi informativ i Servisit të parë programor të Radios së Maqedonisë me 18 orë e 36 minuta ka bindshëm vëllim më të madh kronikash për aktivitetet parazgjedhore të partive, por edhe për Qeverinë dhe ministrinë të cilat ishin në funksion të fushatës zgjedhore. Kjo kohë është ndarë për 26 subjekte politike me disbalanc të theksuar në mbulimin e aktivitetet të tyre.

Për aktivitetet e Koalicionit në pushtet “Për Maqedoni më të mirë” janë ndarë 6 orë e 35 minuta, ndërsa për Koalicionin opozitar “Unioni i ardhmërisë”, vetëm 3 orë e 17 minuta.

Aktivitetet e Qeverisë dhe ministrive në funksion të zgjedhjeve janë mbuluar me 3 orë e 52 minuta. Gjithsej për koalicionin qeveritar dhe Qeverinë janë ndarë mbi 9 orë.

Prandaj është shumë i vogël minutazhi për aktivitetet parazgjedhore të subjekteve politike. Për aktivitetin parazgjedhor të BDI-së janë ndarë 28 minuta, ndërsa për PDSH-në 17 minuta.

TV Sitel

Zgjedhjet lokale në dy ditarët e TV Sitel janë prezentuar mbi 13 orë me ç’rast ka disbalanc drastik. Informimi është përqendruar në aktivitetet e Koalicionit të VMRO DPMNE-së për fushatën e së cilit janë ndarë 5 orë e 49 minuta.

Nëse i shtohet kësaj se aktivitetet e Qeverisë janë përfaqësuar me 2 orë e 42 minuta, atëherë qartë vërehen përmasat e disbalancit. Për këto aktivitete nga gjithsej 13 orë janë ndarë gjithsej 8 orë e 30 minuta.

Për fushatën e Kolicionit opozicionar „Aleanca për ardhmërinë“ janë ndarë vetëm 1 orë e 52 minuta.

Subjektet e tjera politike janë përfaqësuar me minutazh dukshëm më të vogël. Është vërejtur se Partia Progresive Serbe është përfaqësuar me 26 minuta, që është më shumë se koha e ndarë bashkë për BDI-në, 13 dhe PDSH-në 5 minuta.

TV Kanal 5

Zgjedhjet lokale në dy ditarët e TV Kanal 5 janë përfaqësuar me gjithsej 11 orë e 10 minuta. Njoftimi është koncentruar nga dy koalicionet më të mëdha me ç'rast ekziston disbalanc.

Koalicioni “Për Maqedoni më të mirë” i kryesuar nga VMRO-DPMNE është përfaqësuar me pothuaj tri orë, ndërsa Koalicioni opozitar “Aleanca për ardhmërinë” në krye me LSDM-në me rreth 2 orë.

Aktivitetet e “rregullta” të Qeverisë dhe ministrisë janë përfaqësuar me 2 orë e 30 minuta.

TV Telma

Zgjedhjet lokale në dy ditarët qendror të TV Telmas janë prezentuar me gjithsej 11 orë e 18 minuta. Sipas të dhënave të KRK-së në dhjetë ditët e para të fushatës subjektet politike kanë pasur trajtim relativisht të barabartë, por më vonë në gjysmën e dytë të fushatës është vërejtur disbalanc dhe përfaqësim më i madh i opozitës.

Koalicioni i kryesuar nga LSDM-ja është përfaqësuar me gjithsej 3 orë e 5 minuta, ndërsa për Koalicionin në pushtet të kryesuar nga VMRO-DPMNE janë ndarë 1 orë e 53 minuta. Kudrejt kësaj, në njoftimin për partitë shqiptare më shumë kohë gjegjësisht 42 minuta u është kushtuar aktiviteteve të BDI-së, ndërsa PDSH-ja në opozitë është përfaqësuar me 24 minuta.

TV Alsat M

Televizioni Alsat M, media e vetme elektronike me koncesion nacional, i cili emeton program dygjuhësh – në gjuhën shqipe dhe maqedonase – për zgjedhjet lokale ka njoftuar në mënyrën më të balancuar.

Veçanërisht duhet theksuar se në emisionet informative të TV Alsat M pothuajse në mënyrë të barbartë janë prezentuar aktivitetet zgjedhore të partive më të mëdha të pushtetit dhe opozitës. Në mënyrë të balancuar me dallime të pakonsiderueshme në minutazh janë përfaqësuar edhe partitë e shqiptarëve dhe maqedonasve, gjë që nuk ishte rast të mediat e tjera elektronike.

TV Alsat M në dy ditarë televiziv, në orën 19 dhe në orën 23, aktivitetet zgjedhore u kushtoi 10 orë e 33 minuta. Në këtë minutazh, janë përfshirë edhe raportet për aktivitetet e “rregullta” të Qeverisë dhe ministrave.

Parë sipas partive politike aktivitetet e BDI-së u janë kushtuar 1 orë

e 44 minuta, ndërsa PDSH-së në opozitë 1 orë e 11 minuta. Minutazh të ngjashëm kishin edhe partitë e bllokut maqedonas. Për koalicionin e partive të kryesuar nga VMRO-DPMNE janë ndarë 1 orë e 10 minuta, ndërsa për koalicionin opozitar të kryesuar nga LSDM-ja 1 orë e 20 minuta. Për fushatën e partisë opozitare RDK të Rufi Osmanit janë ndarë rreth 50 minuta.

* * *

Vlerësimet e sjelljes së mediave elektronike në fushatën e zgjedhjeve lokale janë bazuar në të dhënat e monitorimit të Këshillit të Radiodifuzionit. Të dhënat ekzakte, të sakta deri në sekondë të këtij monitorimi tregojnë sa mediat elektronike, të cilat kanë ndikim më të madh në opinion, janë nën ndikimin e politikës.

Disbalanci, të cilin e tregojnë të dhënat, vetëm e konfirmon vlerësimin se shumica e mediave elektronike favorizojnë partitë e koalicionit në pushtet. Përndryshe mediat elektronike, janë nën ndikimin e drejt-përdrejtë dhe kontrollin e pushtetit dhe partive në pushtet, para së gjithash të VMRO-DPMNE-së. Favorizimi i mediave elektronike, gjithsesi pati ndikimin e tij edhe mbi rezultatet zgjedhore.

KRK, i cili pas ndryshimit të përbërjes është nën ndikimin e pushtetit dhe partive në pushtet, në bazë të të dhënave të monitorimit personal, tregon për disbalanc të madh në informim. Vlerësimet janë kryesisht të sakta, edhe pse theksohet se aktivitetet e partive në fushatë kanë qenë të ndryshme, ka përpjekje që disbalanci dhe përfaqësimi jo i barabartë i partive, pjesërisht të arsyetohet.

KRK konstatoi disbalanc në njoftimin edhe midis dy raundeve zgjedhore, por kufizohet vetëm me konstatime, pa ndërmarrë masa. E njëjta ndodh edhe pas raportit final, nuk ka masa dhe sanksione për mediat elektronike të cilat dukshëm në mënyrë jo të barabartë kanë njoftuar për këto zgjedhje lokale.

MEDIAT E SHTYPURA

Gjuha e urrejtjes, njëanshmëria dhe satanizimi i oponentëve partiako-politikë, etnocentrizmi, nacional-shovinizmi dhe diskriminimi – kur bëhet fjalë si për çështjet ideologjiko partiake, ashtu edhe për ato më të ndjeshmet, ndëretniket – këto janë karakteristikat kryesore, dominante të raportimit të medias së shtypura për zgjedhjet lokale.

Konstatimi i përgjithshëm për sjelljen e medias në përgjithësi, ashtu edhe për ato të shtypura, gjatë tërë procesit zgjedhor është se pjesa më e madhe e tyre ishin instrumente të dësgjueshme në duart e aktorëve politikë dhe e provuan imazhin e Maqedonisë si vend në të cilin liria e fjalës dhe e mediave është në nivel shumë të ulët.

Ngjarjet kryesore u mbuluan nga pothuajse secili medium, por në shumicën e tyre rëndësi e madhe iu kushtua aktiviteteve të pushtetit, sidomos atij lokal, si për shembull “prerejes së shiritave” dhe “hedhjes së lopatave”, me qëllimin e dukshëm promovimin pozitiv të kandidatëve në këto zgjedhje.

Civil në kuadër të projektit Zgjedhje të lira dhe pa dhunë raportimin e gazetave e ndoqi me metodologji të caktuar e cila nënkuptonte ndjekjen kuantitative dhe kualitative të mënyrës në të cilën ata raportuan për garën ndërmjet pjesëmarrësve në zgjedhjet. Sa i përket vëllimit, duket qartë se të gjitha gazetat e monitoruara, si dhe mediat jera, u kushtuan shumë hapësirë dhe kohë zgjedhjeve lokale.

Sa i përket cilësisë, bie në sy se publiku rrallë mundej tërësisht dhe objektivisht të informohet për tërë procesin elektoral nga vetëm një media. Me fjalë tjera, të pakta ishin mjetet e informimit, dhe e njëjta ndodh edhe me gazetat, të cilat profesionalisht, objektivisht dhe pa anime informonin për të gjitha ato që ndodhnin gjatë zgjedhjeve. Shumica e tyre haptazi dolën në përkrahje të njëres prej palëve pjesëmarrëse, më së shpeshti duke i anashkaluar standardet dhe etikën profesionale.

Nga gjysma e dytë e janarit deri në përfundimin e procesit zgjedhor, nga mesi i prillit, tërësisht u monitoruan, u analizuan dhe u evidentuan shkrimet lidhur me zgjedhjet në gazetat ditore Fokus (deri në mbylljen), Dnevnik, Utrinski vesnik, Nova Makedonija, Veçer, Koha dhe Lajm, si dhe revistat javore Fokus, Gragjanski dhe Republika, me atë që dy të parat ndërkohë u mbyllën.

Të dhënat detale për numrat e teksteve të botuara në secilën gazetë veç e veç, me përshkrime të përmbajtjes së tyre dhe vërejtje të analitëve tanë janë shënuar në tabelat për çdo ditë, që do të gjenden si shtesë e

këtij publikimi në një cd shoqëruese.

Në raportimin tendencioz, me gjuhë të theksuar të urrejtjes ndaj partisë më të madhe opozitare, LSDM-së dhe lidhshimit dhe kandidatëve të saj për kryetarë komunash, printe gazeta e përditshme Veçer. Sjellja e këtillë e kësaj gazete nuk habit kur të merret parasysh mënyra në të cilën kjo gazetë “informon” tashmë vite me radhë. Mospërfillja e të gjitha standardeve profesionale dhe kodekseve etike në periudhën parazgjedhore dhe gjatë vetë zgjedhjeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndodhitë në partitë politike dhe rreth tyre, ishte karakteristika kryesore e kësaj gazete. Veçer, bashkë me TV Sitel te mediat elektronike dhe portalin Kurir në internet-hapësirën, dhanë kontributin më të madh për rrënimin e ambientit medial, që rezultoi edhe me kritika tepër të ashpra nga organizata dhe institucione relevante ndërkombëtare për shkallën e lirisë së shprehjes dhe të medias në vend.

Shkrime të tipit “Paralajmërime për ikje të madhe të anëtarëve nga LSDM-ja”, “Imtësohet fronti opozitar”, “Gruevski porositi: Do ta shohë LSDM-ja se cila është fuqia e popullit”, “U konfirmua debakli i LSDM-së, Branko humbi edhe në Debarcën e vet”, “Janë regjistruar vetëm shkelje më të vogla”, “Përmbysje e politikës së Brankos dhe LSDM-së”, “Në KSHZ u ndanë në patriotë dhe tradhtarë” dhe të ngjashme – ishin pothuajse të përditshme në këtë gazetë. Duhet thënë edhe se gazetarë të Veçerit mjaft rregullisht i ndiqnin konferencat e shtypit të Civilit, porse raportuan vetëm nga njëra prej tyre. Supozojmë se kjo ka të bëjë me faktin se vlerësimet për parregullsitë e shumta të cilat i regjistruan ekipet vëzhgues të Civilit ishin krejtësisht të kundërta me vlerësimet e Veçerit, i cili pohonte se zgjedhjet ishin fer dhe demokratike.

Gazeta Dnevnik, gjithashtu, mjaft hapur e përkrahte koalicionin qeverisës. Por, në këtë gazetë, për dallim nga Veçeri, megjithatë mund të lexoheshin informata edhe për aktivitetet e opozitës dhe deklarata të liderëve dhe kandidatëve të saj. Në Dnevnik jo rrallë mund të lexoheshin edhe tekste të cilat, thënë butë, preknin negativisht në marrëdhëniet ndëretnike. Për ilustrim do të japim disa citate: “Përkundër marrëveshjes që dje u arrit për zgjedhjet lokale, ka mundësi që në ditën e zgjedhjeve të ndodhin disa incidente në më shumë vende. . Dnevnik sipas të dhënave dhe analizave operative transmeton se më problematike janë Çairi dhe Saraji në Shkup, Likova, Kumanova, Tetova dhe Zajazi” (02.03) (Bëhet fjalë ekskluzivisht për komuna me shumicë ose me përqindje të madhe të shqiptarëve); ose, “Në dyvjetorin e incidentit në Kalanë e Shkupit, kur pati rrahje ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, Artan Grubi, kandidat për kryetar të Shkupit nga BDI-ja pikërisht nga vendi i incidentit e shpalli kadidaturën e vet. Ai ishte përkrahës i drejtpërdrejtë i ngjarjeve dhe

është dënuar me kusht, por këtë nuk e quan provokim” (14.02); “Katër di” (mendohet në “katër-dy”, v.j.) – parulla kumanovare për votime; më së shpeshti hynte një burrë i përkatësisë etnike shqiptare, votonte dhe pas tij një grup i tërë njerëzish të cilëve me zë u thoshte “katër di”, që do të thotë 42” (12.04)... Për orientimin proqeveritar të Dnevnikut dëshmojnë artikujt në stilin: “LSDM me bojkotin e manipulon anëtarësinë e vet”, “kryeministri nga mitingu në Shkup porositi: Kundërshtarët nuk kuptojnë se koha i ka shkelur” e të ngjashme.

Politikë më të matur redaktuese, por në të cilën megjithatë mund të vërehej orientimi proqeveritar, kishte Nova Makedonija. Në këtë gazetë mund të lexoheshin qëndrime të cilat janë qartë në linjën e VMRO-DPMNE-së, si p.sh., komenti me titull “Ndarje e votuesve në të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm”, ku thuhet: “opozita i diskriminon dhe i ofendoi maqedonasit nga Pusteci. Çështja për të drejtën e votës të njerëzve tanë nga Pusteci doli jashtë kontrollit dhe u ngrit në temë joreale opozitare; Cili është shkak për disfatën e madhe të LSDM-së; Populli tregoi se nuk dëshiron opozitë të këtyllë”. Gazeta kishte informata të ndryshme, në të cilat ishin të pranishme qëndrimet e të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje, ndërsa orientimi proqeveritar mund të vërehej në tekstet e komentatorëve dhe kolumnistëve. Kështu, në një kolumnë (19.02) mund të lexohej: “LSDM “punon” për VMRO-DPMNE-në! Për shkak të diletantizmit bën çmos që ta dobësojë veten sa më shumë...”.

Me orientim proopozitar, por në pjesën më të madhe duke mbajtur llogari për standardet profesionale dhe normat etike, ishte e përditshmja Fokus. Në qëndrimet e shprehura lidhur me aktorët kryesorë në zgjedhje dominojnë kritikën në adresë të koalicionit qeveritar, por shpesh nuk u kursyen as partitë opozitare. Në pjesën e informacionit kjo gazetë, për dallim nga Veçeri, për shembull, nuk i manipulonte lexuesit e vet me publikim selektiv të informatave, porse përpiquej të paraqesë informacion të plotë për ndodhitë kryesore gjatë zgjedhjeve. Për qasjen kritike ndaj garniturës qeverisëse, në analizat dhe komentet e Fokusit mund të lexoheshin edhe qëndrime si ky në vijim, çfarë rrallë mund të shihen në mediat tjera: “Në vazhden e fushatës zgjedhore, kryetari i VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski, në mitingjet në të cilat duhet t’i prezentojë kandidatët e partisë për kryetarë komunash, vazhdon me këmbëngulje të dalë nga pozicioni i kryeministrit” (11.03).

Në Fokus megjithatë mbizotëron informimi objektiv dhe kështu, për dallim nga gazetat tjera në gjuhën maqedonase, mund të lexohet si në vijim: “Reagime të ashpra të ekspertëve pas vendimit për dalje të përbashkët të VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së në Strugë dhe Kërçovë. Si është e mundur aleanca mes “fashistëve” dhe “komunistëve”? – titullo-

het artikulli lidhur me koalicionin e dy partive më të mëdha dhe më të konfrontuara në dy qytetet ku gjasat ishin reale që të fitojnë kandidatët shqiptarë, gjë që edhe ndodhi në fund. Gjithashtu, kur interviston kandidatin për kryetar komune të një partie gazeta i ofron hapësirë edhe atij të partisë oponente (për shembull: “Zdravko Kocev, kandidat i LSDM-së për kryetar të Shtipit në intervistën për gazetën thotë se do të bëjë gjithçka që të ndalet largimi i mendjeve nga ky qytet. Fokus e kontaktoi edhe kundërkandidatin e Kocevit, Ilčo Zaharievin nga DPMNE-ja, i cili, megjithëse premtoi, nuk iu përgjigj pyetjeve të redaksisë”). Përveç kësaj, në një analizë të gazetës mund të lexohet edhe qëndrimi se: “ofer-ta programore e partive e humbi atraktivitetin, sa për shkak të hyrjes së vonuar të LSDM-së në procesin zgjedhor, aq edhe për shkak të lodhjes dhe mungesës së ideve në VMRO-DPMNE”.

Utrinski Vesnik mund të veçohet si gazetë e vetme objektive në gjuhën maqedonase. Kjo gazetë rregullisht, në mënyrë gjithëpërfshirëse, objektive dhe profesionale informon për të gjitha ndodhitë e rëndësishme në skenën politike maqedonase. Ajo që e dallon nga gazetat tjera maqedonase (pas shuarjes së Fokusit) është numri mjaft i madh i informatave për ndodhitë në bllokun politik shqiptar, me ç’rast mban llogari për prezentim të barabartë dhe jodiskriminues të aktorëve kryesorë në këtë kampus. Me dozën e nevojshme të kujdesit informon edhe për situatat potencialisht konflikte ndëretnike. Kështu, për shembull, lidhur me betejën për kryetar komune mes kandidatëve të dy bashkësive më të mëdha etnike në Kërçovë, pas fjalimit nacionalist të kryeministrit Gruevski në këtë qytet. Me titull “Kërçova të mbetet maqedonase”, Utrinski shkruan: “Kryeministri me porosinë e veta e betanoi luftën etnike për karrigen e kryetarit të komunës, e cila kërcënohet ta dëmtojë rëndë bashkëjetesën në këtë qytet”.

Për neutralitetin e gazetës flasin edhe këta dy shembuj: Përderisa të gjitha gazetat tjera më 09.04. lajmëruan se misioni i OSBE/ODIHR i ka vlerësuar zgjedhjet si “të qeta dhe të realizuara në mënyrë efektive”, “demokratike”, “pa vërejtje” e ngjashëm, Utrinski raporton me titull “ODIHR me shumë vërejtje për zgjedhjet”. Kjo gazetë është gjithashtu e vetmja e cila botoi intervistë me kandidatin e opozitës Andrej Zhernovski pas fitores së tij në komunën Qendër të Shkupit.

Nga mediat e shtypura në gjuhën shqipe përditë u monitoruan dhe analizuan gazetat Koha dhe Lajm. Si zakonisht në proceset elektorale, hapësirë më e madhe u kushtohet partive shqiptare, respektivisht kandidatëve shqiptarë, që është rasti edhe me mediat tjera, respektivisht radiot, televizionet dhe internet portalet në gjuhën shqipe. Pati edhe “tifozeri” për kandidatët e partive shqiptare dhe triumfalizëm pas

fitores së kandidatëve shqiptarë në Kërçovë dhe Strugë. Por, kryesisht publikonin edhe informata për të gjitha ndodhitë më të rëndësishme në bllokun maqedonas. Veçanërisht me intensitet për ngjarjet rreth dy blloqeve kryesore të partive maqedonase raportohej në kohën kur ende nuk dihej se a do të marrë pjesë opozita në zgjedhje apo do t'i bojkotojë. Pas zgjedhjeve në Kërçovë, ku fitoi kandidati shqiptar, Koha boton deklarata të analistëve shqiptarë të cilët apelojnë për unitet të faktorit politik shqiptar për të fituar kandidati i PDSH-së edhe në Strugë. (“Bashkimi i votës shqiptare që rezultoi me sukses me fitoren e Fatmir Deharit në Kërçovë, sipas analistëve politikë shqiptarë është i nevojshëm edhe në tri komunat tjera – Strugë, Bërvenicë dhe Dollnen”, 01.04). Gjithashtu, shkruhet edhe se “në luftën për çdo votë strugane, para rrethit të dytë, ballafaqimi zgjedhor ndërmjet Selës dhe Kocoskit ka dimension tërësisht etnik” (Koha, 03.04.).

Ajo që mund të vërehet te këto dy gazeta është se nuk kanë fushatë negative ndaj asnjë pjesëmarrësi në zgjedhje, as nga blloku shqiptar as nga ai maqedonas, ndërsa nuk mund të shihet as ndonjë favorizim i cili-tdo prej kandidatëve apo partive. Përrjashtim bëjnë pak tekste ku mund të shihet favorizim i dobët, respektivisht shkrime në kontekst pozitiv, për Partinë RDK dhe liderin e saj Rufi Osmanin. Për shembull, në Lajm të datës 01.04., gazetari shkruan se “Diaspora organizoi pritje madhështore për Rufi Osmanin, i cili kërkoi prej tyre përkrahje më 7 prill, kur do të mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve”.

Marrë në përgjithësi, dy gazetatat në gjuhën shqipe u përpoqën që në mënyrë objektive dhe profesionale të mbulojnë pjesën më të madhe të ndodhive gjatë zgjedhjeve.

INTERNET PORTALET

Njëanshmëria ishte karakteristika kryesore gjatë raportimit të internet portaleve për fushatën dhe zgjedhjet lokale, me çka ishte e dukshme edhe ndarja mes portaleve që përkrahin partitë në pushtet dhe atyre që anonin për opozitën. Edhe pse me ndikim më të vogël se media “klasike”, në internet portalet pati shumë informata dhe raporte për zgjedhjet, por ato ishin në mënyrë të theksuar të njëanshme gjatë informimit.

Për dallim nga mediat e shtypura dhe ato elektronike, ku krahas dominimit të theksuar të mediave proqeveritare kishte edhe disa që ishin neutralë, te internet portalet kishte ndarje strikte mes atyre që ishin në anën e partive në pushtet dhe atyre në anën e opozitës.

Te internet portalet, të cilat për shkak të teknologjisë informonin shpejt, kishte shumë informata për ndodhitë gjatë fushatës dhe zgjedhjeve, por ato ishin kryesisht të njëanshme. Me fjalë tjera, te portalet proqeveritare mund të lexoheshin pa përrjashtim tekste pozitive për partinë në pushtet dhe vetëm negative për opozitën, dhe e kundërta – te ato opozitaret ishte e hapur përkrahja për bllokun opozitar dhe e theksuar kritika për pushtetin dhe eksponentët e tij në këto zgjedhje.

Në përkrahjen e hapur për koalicionin të cilit i printe VMRO-DPMNE, fare pa shfaqur dëshirë për t’u dhënë hapësirë oponentëve të saj, dallohet portali kurir.mk, te i cili opozita është e pranishme pa përrjashtim vetëm në kontekst negativ. Dominante te ky medium haptazi pro-vmrovash ishte promovimi intensiv i të gjithë kandidatëve për kryetarë komunal të kësaj partie dhe kolaicionit të saj, me shkrime të panumërta për aktivitetet, për programet dhe premtimet e tyre. Në anën tjetër, Kurir për fushatën e opozitës pothuajse fare nuk informonte. Edhe në rastet kur kishte informata për opozitën, ato ishin tendencioze, me relativizim të numrit të pjesëmarrësve në mitingje, me çka krijoheshin pamje joreale për përkrahjen të cilën ajo e ka te elektorati.

Gjuha e urrejtjes ndaj opozitës ishte pjesë e politikës redaktuese të këtij portali. Fyerjet të cilat ndaj personaliteteve të LSDM-së i adresonin liderët e VMRO-DPMNE-së transmetoheshin në vendet kryesore në ueb me tituj bombastikë. Ndërkaq, asnjëherë nuk iu dha hapësirë liderëve ose përfaqësuesve të opozitës që t’u përgjigjen fyerjeve dhe akuzave të ndryshme. Shkurt, Kurir dhe disa portalet tjera të ngjashme karakterizohen për mungesë absolute të objektivitetit, profesionalizmit dhe etikës. Identike si te Siteli (ndër mediat elektronike) dhe Veçeri (te gazetatat)

edhe te Kuriri kur bëhet fjalë për raportimet për zgjedhjet dhe partitë, nuk mund të vërehet dallim mes informatës dhe komentit.

Përveç disa portaleve të ashtuquajtura “satelite” të Kuririt, që shërbejnë për disperzion më të madh të përkrahjes së partisë pushtetmbajtëse, dukshëm tendencioz në mënyrën e raportimit ishte edhe portali press24.mk. Karakteristike për këtë portal është që nuk kishte gjuhë të theksuar të urrejtjes, por publikonte dhe transmetonte spekulime qëlimi i qartë i të cilave ishte që ta dëmtojnë autoritetin e LSDM-së dhe lidhshpirtit të saj. Njëjtë si dhe Kuriri, edhe ky portal nuk i dha mundësi opozitës që të përgjigjet ndaj spekulimeve dhe akuzave.

Anshmërinë e këtij mediumi më dukshëm e tregon zgjedhja e personave që intervistohen ose që u jepet hapësirë për t’i shprehur qëndrimet lidhur me ndodhitë atëherë aktuale në skenën politike. Bëhet fjalë pa përjashtim për funksionarë të partisë në pushtet, kandidatë për kryetarë komune nga e njëjta dhe politikanë, gazetarë dhe analistë të ndryshëm të cilët kanë qëndrime qartë të definuara dhe të promovuara kundër opozitës dhe njerëzve të saj kryesorë. Asnjëherë gjatë tërë asaj periudhe nuk u intervistua asnjë opozicioner dhe nuk u botua asnjë kolumnë ose analizë në të cilën do të kritikoheshin pushteti dhe partia qeverisëse, ose do të përkrahej opozita.

Duhet thënë edhe se ky portal para se të fillojë procesi zgjedhor kryesisht u përmbahej standardeve profesionale dhe etike, por krejtësisht i “harroi” gjatë këtij procesi. “Kthesa” e këtillë në politikën redaktuese me siguri mund të shpjegohet me paraqitjen e reklamave të VMRO-DPMNE-së për zgjedhjet, si dhe të fushatave mediale qeveritare.

Ndër disa internet mediat të cilat ishin, thënë kushtimisht, me orientim proopozitar, dallohet plusinfo.com, te i cili oponenca përbëhej nga qasja haptazi kritike ndaj partisë qeverisëse dhe akuzat në llogari të së njëjtës për malverzime dhe kurdisje të zgjedhjeve. Megjithatë, duhet cekur se, për dallim nga portalet si Kurir, në Plusinfo nuk mund të vëreheshin gjuhë e urrejtjes gjuhë e urrejtjes dhe joprofesionalizëm dhe se pothuajse nuk pati fare informim selektiv për fushatën. Në pjesën informative vëreheshin niveli i lartë i profesionalizmit dhe informimi gjithëpërfshirës dhe objektiv për të gjitha ngjarjet rreth zgjedhjeve. Animi ndaj opozitës në këtë media mund të shihet në kolumnat, në të cilat, më së shpeshti, partia pushtetmbajtëse akuzohej për falsifikim të zgjedhjeve dhe në mënyrë të hapur përkrahehin kandidatët e opozitës.

Ngjashëm, madje mund të thuhet në mënyrë identike, informonin edhe novatv.mk, a1.on.mk, libertas.mk, brif.mk. Te këto dhe disa portale të tjera, në pjesën e kolumnave, intervistave, analizave, po edhe pjesërisht në mënyrën e raportimit dhe zgjedhjen e informatave, mund të vërehet

anueshmëria dhe përkrahja e bllokut opozitar dhe qasja kritike ndaj partisë qeverisëse dhe partnerëve të saj të koalicionit.

Për dallim nga portalet që u përmendën më sipër, mkd-news.com i ndoqi në mënyrë neutrale aktivitetet e të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje dhe informonte me dozën e neojshme të qasjes kritike. Në këtë portal kishte vend edhe për opozitën që të përgjigjet ndaj akuzave dhe spekulimeve të pushtetit dhe partisë kryesore qeverisëse.

Portalet në gjuhën shqipe, ngjashëm si mediat tjera në këtë gjuhë, pjesën më të madhe të hapësirës ia kushtuan garës zgjedhore ndërmjet partive shqiptare – BDI-së pushtetare dhe PDSH-së dhe RDK-së opozitare.

Si tejet i njëanshëm dhe përkrahës tendencioz i BDI-së gjatë tërë procesit zgjedhor dallohej portali zhurnal.mk. Ky portal, ngjashëm si Kuriri nga internet mediat në gjuhën maqedonase, perceptohet si “organ informativ” i BDI-së.

Te ky portal vërehej disbalanc drastik kur të shihet numri i artikujve në përkrahje të BDI-së. Zhurnal jo rrallë botonte edhe manipulime dhe zhvillonte fushatë negative ndaj opozitës në bllokun politik shqiptar. Për ilustrim: I pyetur se a do të paraqesë dorëheqje “pas humbjes së thellë në të gjitha komunat shqiptare”, lideri i PDSH-së Menduh Thaçi përgjigjet se “edhe kjo është e mundur, në rast se atë e kërkojnë 90 mijë aktivistë të PDSH-së, por jo të tjerët të cilët votuan kundër kësaj platforme”. Zhurnal artikullin e boton me titull “Thaçi mund të paraqesë dorëheqje?”.

Ngjashëm, me favorizimin e partisë qeverisëse, por pa manipulime aq të dukshme dhe fushatë negative, raporton edhe platforma në gjuhën shqipe e Kuririt, sq.kurir.mk. Karakteristike për këtë portal është se lidhur me zgjedhjet, dominojnë artikuj të përkthyer nga portali amë.

Te internet mediat tjera maqedonase në gjuhën shqipe, si portalb.mk, almakos.mk, tetova1.com... mund të vërehet informim i balancuar dhe objektiv për aktivitetet e të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhjet, me nga ndonjë artikull kritik në llogari të partive të koalicionit qeveritar.

AGJITATORË TË NACIONALIZMIT

Fushata për zgjedhjen e kryetarëve të komunave të Kërçovës dhe Strugës në mënyrë të sublimuar dhe në një vend e treguan dhe deri në fund e zhveshën rolin e turpshëm të cilin shumica e medias e luajtën në këto zgjedhje. Gazetarët dhe media në mënyrë aktive iu bashkangjiten retorikës nacionaliste të partive politike, në nxitjen e animozitetit ndëretnik, që paraqet kulmin e keqpërdorimit të profesionit dhe shkelje të rëndë të kodeksit dhe normave dhe standardeve profesionale.

Një pjesë e medias ishin (bashkë)pjesëmarrës aktivë në keqpërdorimin e nacionalizmit nga ana e partive politike, që në disa çaste ishte në kufi me hysterinë nacionaliste. Sjellja e këtyre partive, të përkrahura nga një pjesë e medias, nuk mund të mos lë gjurmë dhe pasoja mbi marrëdhëniet ndëretnike, jo vetëm në Kërçovë e Strugë, por edhe më gjerë, në tërë vendin. Retorika nacionaliste, apo thënë më saktë keqpërdorimi i nacionalizmit në fushatën për zgjedhjet lokale, u imponua nga partitë politike më me ndikim nga blloku maqedonas dhe ai shqiptar. U bënë koalicionet “të panatyrshme”, me ç’rast edhe partitë e koalicionit qeveritar edhe ato të opozitës u konfrontuan mbi baza etnike. U krijuan “aleanca” të reja etnike/nacionaliste ndërmjet partive të maqedonasve (VMRO-DPMNE dhe LSDM) dhe partive të shqiptarëve (BDI dhe PDSH). Të tilla ishin kushtet në të cilat mediat dhe gazetarët raportonin për aktivitetet dhe retorikën të cilën e përdornin liderët, kandidatët dhe aktivistët në këto koalicionet të përkohshme dhe të qëllimta etniko/nacionaliste. Raportet ditore në media kryesisht saktë e transmetonin atmosferën në të cilën zhvillohej fushata. Qytetarët rregullisht informoheshin për atmosferën e nxehur në të cilën zhvilloheshin zgjedhjet në Kërçovë dhe Strugë. Por, vetëm një numër tepër i vogël, i pavërejtshëm i medias me politikën e vet redaktuese, me komentet dhe qëndrimet u distancuan nga retorika nacionaliste e partive dhe e dënuan nxitjen e mosdurimeve ndëretnike. Kjo ishte edhe një dëshmi për anueshmërinë e medias dhe lidhjet e tyre me partitë. Një pjesë e medias dhe gazetarëve jo vetëm që ishin të njëanshëm, por shkuan edhe shumë më larg, u lëshuan në retorikë nacionaliste dhe në nxitjen e mosdurimit dhe urrejtjes ndëretnike. Këto media silleshin si pjesëmarrës dhe aktorë aktivë në fushatën dhe haptazi merrnin anë në ndarjen etniko/nacionaliste në funksion të zgjedhjeve.

Në radhët e para ishin mediat të cilat gjatë tërë fushatës haptazi dolën

në anën e partive në pushtet ose të njërit prej opcioneve etnike. Këto ishin edhe promotoret e fushatës së partisë më të madhe në pushtet, VMRO-DPMNE. Kjo, para së gjithash, vlen për TV Sitel dhe Programin e parë të televizionit publik, MTV-së, pastaj për gazetën Veçer dhe portalin Kurir, të cilët në këto zgjedhje ishin agresivë si kurrë më parë.

Në mediat në gjuhën shqipe, përveç anueshmërisë, respektivisht “tifozërisë” për kandidatët shqiptarë në Kërçovë dhe Strugë, nuk u vërejt gjuhë e urrejtjes. Por, pas fitores së kandidatit shqiptar në Kërçovë, pati triumfalizëm, ndërsa këto media, duke cituar politikanë dhe analistë shqiptarë, thirrën për unitet të faktorit politik shqiptar në komunat Strugë, Bërvenicë dhe Dollnen me qëllim që të mundet kundërkandidati maqedonas. Pas përfundimit të zgjedhjeve në Kërçovë dhe Strugë të këto media mund të vërehej kënaqësi e hapur për rezultatin përfundimtar, me ç’rast kishte edhe porosi të tipit “Kërçova më në fund shqiptare” dhe “Struga e shqiptarëve”. Duhet përmendur edhe faktin se, si pasojë, gjuha e urrejtjes, fyerjet personale dhe nënçmimet e kundërshtarëve të partisë maqedonase në pushtet, që ishin të pranishme gjatë tërë fushatës, u përcollën edhe në sferën e marrëdhënieve ndëretnike. Shembull më mbresëlënës për këtë ishin edhe raportimet dhe komentet rreth fjalimeve të kryeministrit Gruevski në mitingjet në Kërçovë dhe Strugë. Ato ishin përplot nacionalizëm, animozitet etnik, kufizoheshin me histeri. Kjo nuk i pengoi mediat që janë nën kontroll të partisë së tij - apo këtë e bënë pikërisht për shkak të tonit dhe përmbajtjes së fjalimeve të tij – që këto fjalime t’i quajnë “historike”. Çka ka historike në nxitjen e nacionalizmit dhe mosdurimit dhe urrejtjes ndëretnike? Përgjigjen e dinë vetëm lideri i partisë në pushtet dhe mediat nën kontrollin e tij, të cilat me plot kuptimin e fjalës përditë bëjnë gara se kush do të jetë më puthador se tjetri. “Arritjet” më të larta në rolin e turpshëm, të cilin e patën një pjesë e medias gjatë fushatës lidhen me ndodhitë rreth zgjedhjeve në Kërçovë dhe Strugë. Sjellja e partive politike dhe roli i një pjese të mediave, patën dhe do të kenë pasoja mbi marrëdhëniet ndëretnike, jo vetëm në këto dy komuna por edhe më gjerë. Tashmë u bë praktikë që nacionalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike, partitë në pushtet, por edhe ato në opozitë, t’i mbajnë të hapura dhe t’i përdorin për nevoja ditore-politike. Këtë e provon edhe deklarata e liderit të partisë në pushtet i cili, pasi u prit me fishkëllima gjatë vizitës në Kërçovë pas përfundimit të zgjedhjeve, deklaroi se “solidarizohet me mllëfin e kërçovarëve”. Mbeti e paqartë pse në fakt është i mllëfësor kryeministri. Për disfatën e opcionit të tij etnik/nacionalist në Kërçovë, për qytetarët që morën guxim të protestojnë, apo për median nën kontrollin e tij.

RAPORTIMI I MEDIAVE PËR FUSHATËN NË KËRÇOVË/STRUGË

Përzgjedhje nga monitorimi i përditshëm i mediave të shtypura që u zhvilluan në periudhën 12 janar – 22 prill 2013.

15. 03. 2013

Fokusi ditor

Në shkrimin “ Ahmeti për Shqipëri etnike, Gruevski për Maqedoni të maqedonasve” shkruhet për tubimet në Strugë dhe Kërçovë, ku VMRO-DPMNE dhe LSDM veprojnë të bashkuar, kurse në të cilat kryeministri Gruevski i thërret të gjithë maqedonasit, pa marrë parasysh se a i takojnë partisë në pushtet, të opozitës apo janë të pacaktuar, ta përmbajnë kandidatin e përbashkët për të mos i dhënë mundësi kandidatit shqiptar, kurse BDI nga ana tjetër zhvillon fushatë agresive për mbledhje të votave shqiptare dhe premtion realizimin e ëndrrës për “ Shqipëri etnike” (faqe 4);

Dnevnik

Bllagoja Despotovski, kandidat për mandat të dytë dhe kryetar aktual i Kërçovës nga VMRO-DPMNE , në intervistë për gazetën thotë se bashkëpunimi me LSDM-në ka qenë diçka që e kanë kërkuar qytetarët e Kërçovës, kurse politikanët duhet të dëgjojnë zërin e qytetarëve. Mendon se fitorja e tij me 24 mars nuk do të jetë vetëm fitore nga votat e maqedonasve etnik, por edhe nga turqit dhe romët (faqe 2); “Gruevski dhe Ahmeti në kacafytje për Strugën dhe Kërçovën”. Për liderin e BDI-së, bashkëpunimi mes partive maqedonase i ngjan macës dhe miut dhe është i bërë nga paniku dhe frika, përderisa Gruevski mendon se votimi në të dy qytetet është rast historik për të përmirësuar gabimin me organizimin territorial (faqe 2);

Nova Makedonija

Pa ikonografi partiake në bllokun partiak maqedonas në Kërçovë, për herë të parë në zgjedhje lokale partitë kanë rënë dakord që në tubimet në Kërçovë të mos ketë ikonografi partiake, por të jenë të theksuar

flamuri maqedonas dhe flamuri i qytetit. Gjithashtu u vendos që blloku maqedonas të ketë vetëm një zyre zgjedhore (faqe2);

Veçer

Tubimi i partisë qeverisëse në Maqedoninë Perëndimore. Gruevski : “ Këto janë zgjedhje historike për Strugën. Kemi rast të madh historik që radikalëve dhe nacionalistëve t’u tregojmë se këtë shtet të gjithë e ndiejnë si Maqedoni” (faqe 4);

Fokusi javor

“Betejë etnike për Kërçovën dhe Strugën”; kuriozitet i zgjedhjeve lokale në vijim do të jetë bashkëpunimi formal mes dy subjekteve më të mëdha maqedonase. Pas bashkimit të fuqive të BDI-së dhe PDSH-së, fuqitë i bashkuan edhe VMRO dhe LSDM për dy komuna me qëllim që kryetari të bëhet maqedonas. A do ta ndryshojë Gruevski riorganizimin territorial apo Ahmeti do ta vizatojë Shqipërinë etnike? (faqe 10);

Republika

“Zgjedhje lokale për shtete të mëdha”- BDI porositi se në qoftë se në Kërçovë nuk fiton komandanti i UÇK-së Dehari, shqiptarët në këtë qytet nuk do të marrin frymë (faqe 6);

16-17. 03. 2013

Fokusi ditor

VMRO-DPMNE dhe BDI, për Kërçovën dhe Strugën kundërshtarë, në rrethin e dytë bashkëpunëtorë. Komunitat në të cilat u nevojitet përkrahje e ndërsjellë janë Çairi, Manastiri, Shkupi, Tetova dhe Gostivari (faqe 6);

Dnevnik

“Gruevski: Kërçova ka qenë dhe do të mbetet Maqedoni” (faqe 6).

Utrinski vesnik

“Kërçova të mbetet maqedonase”; kryeministri me mesazhet e tij e forcoi betejën etnike për karrigen e kryetarit të komunës, e cila kërcënon ta shkatërrojë bashkëjetesën në qytet (faqe 8);

Nova Makedonija

Kërçova t'iu ngelet të gjithë qytetarëve, këtë e porositi Gruevski në tubimin dhe promovimin e kandidatit për kryetar komune Bllagoja Despotovski. “Duan në mënyrë artificiale ta ndryshojnë imazhin etnik të Kërçovës, me etno-nacionalizam të fitojnë pushtetin në këto hapësira” (faqe 2);

Maqedonia para zgjedhjeve- reportazh nga Struga; “Urat ta bashkojnë Strugën”;

Në këto zgjedhje tre persona do të luftojnë në betejën për kryetar të komunës së Strugës (faqe 4).

Veçer

Tubim i koalicionit “Për Maqedoni më të mirë” Gruevski: Të tregojmë se e kujt është Kërçova (faqe4).

18. 03. 2013

Dnevnik

Patriotizëm modern i kundërshtarëve politikë. Igor Ivanovski dhe Antonio Milloshovski së bashku në Strugë dhe Kërçovë; dallimet politike këtu janë të tejkaluara, jetë më të mirë do të ketë për të gjithë pa marrë parasysh përkatësisë etnike, premtuan përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së (faqe2);

Utrinski vesnik

Kërçova dhe Struga, test për koalicionin në “Ilindenska”; si do të ndikojë aleanca e çastit mes DPMNE-së dhe LSDM-së në nivel lokal në komunikimin mes partnerëve në qeveri (faqe 6);

Veçer

VMRO-DPMNE dhe LSDM në konventën e përbashkët i porositen struganët: “ Fitore për Strugën është e mundur vetëm me pjesëmarrje masive” (faqe 4);

19. 03. 2013

Dnevnik

Grindje mes Thaçit dhe Ahmetit për Strugën; nga partitë këmbëjnë oferta me të cilat do të mundësohet që blloku politik shqiptar, përveç për Kërçovën në zgjedhjet të bashkëpunojë edhe për Strugën (faqe 2);

Nova Makedonija

Në letër qytetarë, në tubime nacionalistë; programet e Deharit dhe

Llabenishtës premtojnë zhvillim të barabartë për komunën pa dallim të përkatësisë etnike të popullatës, por ato nuk mund të prekin deri te votuesit maqedonas dhe deri te tjerët të cilët nuk e kuptojnë gjuhën shqipe, sepse nuk janë të përkthyer (faqe 4).

25. 03. 2013

Fokusi ditor

Pasiguri deri në momentin e fundit; betejë e rëndë votuese për Kërçovën. Në Kërçovë kanë arritur më shumë se 3 mijë emigrantë, përderisa për bllokun maqedonas kanë arritur 2 autobusë nga Italia dhe Serbia (faqe 6);

Dnevnik

Në Kërçovë qetë dhe masivokishtë; numërimi jozyrtar i votave ka filluar në orën 21, përmendet se ka pasur edhe grindje, kurse në udhëheqje janë ndërruar të dy kandidatët në varësi prej asaj se në cilin vend janë numëruar votat (faqe 2);

Nova Makedonija

Në Strugë dhe Kërçovë votohej dhe kremtohej; Struga në orën 10 ngjasonte si në mes të stinës turistike (faqe 2);

26. 03. 2013

Fokusi ditor

Dehari me karrocë dhe kalë të bardhë do të shëtitet nëpër Kërçovë; për fitoren e kryetarit të komunës Kërçovë nga rradhët e BDI-së, ka qenë e ngjyrosur karrocë në ngjyrë të bardhë në të cilën ka pasur shqiponjë dy krerëshe dhe flamur shqiptar (faqe 8);

27. 03. 2013

Fokusi ditor

Gruevski i fishkëlluar nga ana e përkrahësve të VMRO-së në Kërçovë; grup më i madh i qytetarëve nga nacionaliteti maqedonas nuk e lejoi ta braktisë selinë e partisë derisa të mos përgjigjet se si u bë që BDI të fitojë në Kërçovë (faqe 8).

Dnevnik

VRMO-DPMNE dhe LSDM e kontestojnë fitoren e Deharit në Kërçovë;

koalicioni për mbështetje të Bllagoja Despotovskit dhe ka ngritur kundërshtime për 7 vende votimi me të cilat mund të vihet në pikëpyetje fitorja e kandidatit të BDI-së (faqe 2);

Utrinski vesnik

Gruevski i qetësonte kërçovarët; maqedonasit në Kërçovë të revoltuar sepse për herë të parë qytetin do ta udhëheqë shqiptar (faqe 6);

Veçer

Kryeministri dhe nga Kërçova porositi: E kuptoj zemërimin e kërçovarëve, ai është edhe zemërim i imi (faqe 3).

29. 03. 2013

Utrinski vesnik

Pritje të mëdha – zhgënjime të mëdha në Kërçovë; “Shqiptarë në komunë janë 28. 000, kurse maqedonas 16. 000. Por ne jemi numër real, ne jetojmë këtu, ndërsa shqiptarë janë rreth 5000, komentojnë nga shoqata “Kërçovarët për Kërçovën” (faqe 9).

01. 04. 2013

Veçer

Si e shiti LSDM-ja Kërçovën – të premten e kaluar Sitel publikoi se LSDM-ja ka arritur marrëveshje me BDI-në që të mos mbështesë votimin për prishjen e dy vendeve zgjedhore në Kërçovë, me çka Cërvenkovski i ka mundësuar Deharit që të zgjidhet që në rrethin e parë (faqe 4);

LUFTË
E PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHTET

LUFTË
E PASKRU-
PULLT
PËR
PUSHTET

REKOMANDIME

LUFTË E PASKRU- PULLT PËR PUSHTET

REKOMANDIME

Rekomandimet në vijim janë mesazhe koncize të cilat rrjedhin nga analiza dhe raportet nga terreni të mbledhura nga ekipet për monitorim të Civilit dhe organizatat partnere. Secila pjesë nga rekomandimet bazohet në vëzhgim të kujdeshëm dhe zgjedhje të çështjeve më kryesore për të mundësuar kushte afatshkurta dhe afatgjata për zgjedhje me të vërtetë të lira dhe pa dhunë në të ardhmen, si dhe të përmirësohen gjendja e të drejtave të njeriut dhe demokracisë në vend.

Për Qeverinë, institucionet shtetërore dhe administratën

Ligjore

- Zgjidhni problemet me listën e votuesve (për shembull, zhvendosja e personave prej një vendvotimi në tjetër mes rrathëve të votimit).
- Aplikoni masa për ndalimin e intervenimeve demografike. Për shembull: të jetë e nevojshme periudhë për qëndrim minimal (për shembull 6 muaj) para se të fitohet e drejta e votimit në komunë.
- Ndryshoni legjislativën që të futet votimi preferencial.
- Qartësoni definicionin për „fushata të hershme“ dhe futni sanksione më rigorozë.
- Përforconi legjislacionin për financimin e partive dhe krijoni sistem të sanksioneve serioze për shkelje.
- Krijoni sistem të votimit në mungesë në vend të votimit në diasporë për t'i shmangur hutimet e mëtutjeshme për rolin e votuesve në diasporë.
- Ristruktuoni përbërjen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) dhe të komisioneve komunale zgjedhore (KKZ) në organe jopartiake dhe joadministrative.

Politike

- Filloni debat për ndryshimin e sistemit në votim preferencial
- Filloni dialog politik në vend
- Aplokoni masa për përforsimin e respektit ndaj të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimin e ligjit në kontekst të zgjedhjeve

Institucionale

- KSHZ-ja, prokuroria dhe MPB-ja duhet të fillojnë të punojnë sipas detyrës zyrtare dhe të hapin procedura për akuzat për mashtrime, duke përfshirë edhe presionin zgjedhor.
- KSHZ-ja, prokuroria dhe pushtetet përkatëse t'i shqyrtojnë pohimet për letërnjoftime të dyfishta.

Mediat

- Qeveria duhet të sigurohet se ekzistojnë kushte për liri të fjalës dhe mediave
- Zbatoni standardet ekzistuese, ligjet dhe rregullat për të siguruar transparencë në pronësinë e mediave
- Ndaloni procedurën për përgatitjen e ligjit për media sepse është i padobishëm.
- Krijoni kushte për çrrënjësimin e monopolit në distribuimin e mediave të shtypura dhe mundësoni sistem profesional të shpërndarjes.
- Plotësoni obligimin i cili buron nga marrëveshja me BE-në nga 1 mars për qartësimin e ngjarjeve të 24 dhjetorit të vitit 2012, duke përfshirë edhe dhunën kundër gazetarëve.

Për shoqërinë civile dhe mediat

- Shfrytëzoni sistemin juridik dhe parashtroji padi kur ekzistojnë informata për mashtrime zgjedhore.
- Krijoni koalicion/platformë kundër mashtrimeve zgjedhore dhe kërkoni ndihmë ndërkombëtare.
- Aktivitetet zgjedhore vëzhgoni edhe mes zgjedhjeve.
- Rregulloni statusin shoqëror dhe profesional të gazetarëve dhe të punësuarve në media në pajtim me kërkesat e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Medialë.
- Përgatitni kodekse etike/kodeks të sjelljes për mediat e shtypit dhe internet mediat gjatë proceseve zgjedhore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.8:352(497.7)"2013"(047.31)

REPUBLIKA e Maqedonisë, zgjedhje locale 2013 : luftë e paskrupullt për pushtet : analiza, raporte dhe rekomandime / [autorë Xhabir Deralla ... и др.]. - Shkup : CIVIL - Qendra për Liri, 2013. - 98 стр. ; 21 см

Автори: репорте dhe analiza Xhabir Deralla, Harald Shenker, Albulena Karaga, репорте për mediat Risto Popovski, Ilir Ajdini, Anushka Cvetkovska

ISBN 978-9989-2001-6-8

1. Deralla, Xhabir [автор]

а) Локални избори, 2013 - Македонија - Истражувања
COBISS.MK-ID 94338314

WWW.CIVIL.ORG.MK

ZGJEDHJE TË LIRA DHE PA
DHUNË PROJEKT 2013



financiarisht i përkrahur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

WWW.CIVIL.ORG.MK